

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7321 E premte 13 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion i Ditës

Hyrja në skemën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-së) të biznesit të vogël me xhiro vjetore deri në 5 milionë lekë të reja duke filluar nga data 01.01.2018 ...  
Vijon në faqet 18-19

Nga ZIJA LIKA  
TVSH te biznesi i vogël mund të sjellë rritje çmimesh



## Opinion i Ditës

Thuaje 10 ditë më parë, ambasadori i SHBA, Donald Lu, duke i hequr krejtësisht dorashkat diplomatike, foli qartë dhe prerë, teksa shprehej: ...  
Vijon në faqen 20

Nga BESNIK BAKIU  
Krimi i organizuar, si rrezik ekzistencial



Debatet e fyerjet pa mikrofon mes deputetëve  
**Tensione në Kuvend, opozita bllokon foltoren, Ndoka përjashtohet**

Lulzim Basha: Rama shantazon opozitën.  
Kryeministri: Parlamenti, jo klub të dehurish

Nga DARINA TANUSHI

Byroja e Kuvendit vendosi mbrëmë përjashtimin e deputetit të Partisë Demokratike, Flamur Noka me 10 ditë nga punimet e Kuvendit. Përjashtimi i Nokës u bë me 5 vota të mazhorancës, pasi ...  
Në faqet 2-3

## PAMJET FILMIKE ZBULOJNE DY AUTORET, NE KERKIM LAERT HAXHIU E ORGES BILBILI

# MASAKRA NE LUSHNJE, VELLAI: O DO I VRAS, O DO ME VRASIN

Jurgen Hoxha erdhi para një jave nga Holanda për dasmë, kushërira: Të të qaj ty, apo motrën! Viktimat panë autorët, Zamir Latifi: Çuna, na vranë!



(Në foto) Dy autorët e dyshuar, Laert Haxhiu dhe Orgest Bilbili. Ekspertët e policisë në vendin e ngjarjes

### FLASIN FQINJET

**Nipi plagos me thikë gjyshërit, polici e kyç në bankë, si ndodhi**  
Në faqen 11

### KARRIERA NE POLITIKE

**Shuhet në moshën 49-vjeçare pas një sëmundjeje të rëndë ish-ministri Prifti**  
Në faqen 15

### TAKIMI ME HARADINAJN

**Meta: Duhet dialog konstruktiv i të gjitha forcave për ardhmërinë e Kosovës**  
Në faqen 6

### LISTA E PERDITISUAR

**Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës**  
Në faqet 21-22

### DEBATI PER BUTRINTIN



**Forumi i Trashëgimisë 'rrëzon' Kumbaron: Është gërmuar 30 cm, betoni është ndërtim**  
Në faqen 16

Vajza e aktorit të madh, Viktor Gjoka: Nëna ime ishte asistentja e tij dhe kontribuoi në rritjen artistike

## Floreta Gjoka: S'kam qenë kurrë shoqja e gruas së babait tim

"Kam 50 vjet që e vuaj këtë mashtrim. Unë kam norma të larta morale"

Nga FLORETA GJOKA

Unë jam Floreta Gjoka, një nga vajzat e regjisorit dhe aktorit Viktor Gjoka, historia personale e të cilit përveç se na vrau para 50 vitesh, po na rivret sërish sa herë që në gazeta botohen artikuj mbi jetën e tij private.



Unë kam qenë vajzë e rritur kur babai im vendosi të linte nënën dhe katër fëmijë që ishim ne, për të nisur një histori të re. Se si nisi, ne as nuk kemi dashur të futemi në të thella e të merremi me të, pasi unë kisha një nënë fisnike që ...  
Në faqen 15

## PARLAMENTI DEBATET

Byroja e Kuvendit përjashtoi 10 ditë Nokën, Tushaj i LSI kundër

# Basha: Rama shantazhon opozitën Rama: Parlamenti, jo klub të dehurish

Kreu i PD nxjerr foton: PS mbrojti "të fortin" nga Shijaku

Darina Tanushi

Byroja e Kuvendit veni dosi mbrëmë përjashtimin e deputetit të Partisë Demokratike, Flamur Noka me 10 ditë nga punimet e Kuvendit. Përjashtimi i Nokës u bë me 5 vota të mazhorancës, pasi tri vota të PD-së përfshirë këtu edhe votën e deputetit të LSI-së, Viktor Tushaj kanë qenë kundër ndëshkimit të Nokës. Ndërkohë, byroja ka rrefuzuar kërkesën e PD dhe LSI për përjashtimin e kryeministrit Edi Rama për fyerje ndaj ish-kryetarit të PD dhe njëherazi ish-kryeministrit Sali Berisha. Pas mbledhjes, nënkryetari i Kuvendit, demokrati Edi Paloka tha se deputeti Noka nuk ka shkelur asnjë nen të rregullores. "Gramoz Ruçi po zbaton urdhrat e Edi Ramës për ta kthyer këtë Parlament në një kuvull të Partisë Socialiste. Në mënyrë cinike na u tha, 'atëherë keni të drejtën të bëni një mocion mosbesimi ndaj kryetarit'. Ta harrojnë se do t'i mbyllin gojën opozitës. Ne do të jemi deri në fund për të mbrojtur të drejtat tona", tha djepaloka.

### REAGIMET

Pas mbylljes së seancës së Kuvendit, kryeministri Edi Rama u shpreh jashtë sallës për gazetarët: "Nuk po ia dalim dot që të arrijmë në momentin që opozita të bindet që parlamenti klub të dehurish, siç ishte katër vjet ka vdekur në 25 qershor". Sipas Ramës, "ky parlament ka nisur të funksionojë dhe do të vazhdojë të funksionojë do apo nuk do PD bashkë me motrën tonë të përbashkët, LSI". "Është rihapur çadra, është rivënë pllaka e gramafonit të parazgjedhjeve. Është një opozitë pa vizion, pa program, pa skuadër, pa përgjegjësi", u shpreh kryeministri. Ndërsa, për sharjen ndaj Berishës, Rama u shpreh se i doli nëpër dhembë. Nga ana e tij, kreu i PD-së, Lulzim Basha u shpreh: "Nuk ka dhe nuk do të ketë

kurrë një përsëritje të një parlamenti kukull në duart e krimt dhe mafies dhe kukullave të tij".

### DENONCIMI

Emra të njohur të botës së krimt në vend dhe familje mafioze që veprojnë në vendin tonë kanë shantazhuar opozitën shqiptare dhe liderin e saj. Lajmi është konfirmuar nga kreu i PD-së, Lulzim Basha, sonte në studion e emisionit "Opinion", ndërsa theksoi se opozita ka

denoncuar me emra dhe për hir të këtij denoncimi, Edi Rama i ka hedhur t'i bëjnë shantazh dhe kërcënime opozitës dhe kreu të saj. "Ky është Edi Rama, të mërkurën hedh cubat për të kërcënuar opozitën, të enjten hedh Gramoz Ruçin për t'i mbyllur gojën opozitës", tha Basha. Kreu i PD-së u shpreh se i arrestuari një ditë më parë, Durim Keçi ka lidhje me Ramën. Ai është shprehur se ai e ka ndihmuar

Ramën për të fituar zgjedhjet në Durrës. "Gjatë zgjedhjeve Durim Keçi është vënë në shërbim të Edi Ramës. Le të vijë ta mohojë ai dhe shkojmë të shikojmë tabulatet. Pse është arrestuar tani? Ai i tha se 'nuk ka bir nënë që të të ekstradojë ty në Itali sa të jem unë kryeministër'. Nuk e dimë nëse mund të ekstradohet, sepse mund të humbasë rrugës. Me këtë njëri e ka marrë pushtetin Rama dhe Vangjush Dako".



Priligi për pakicat, replika mes kreut të PBDNJ-së dhe kryeministrit

## Rama-Dules: Vangjel, ti je minoritar, Evropa nuk është kishë e xhami

Në seancën e Kuvendit u diskutua dhe projektligji për pakicat kombëtare, ndërsa ka pasur replika mes kreut të PBDNJ, Vangjel Dule me ministrin e Jashtëm, Ditmir Bushati. Dule ka kërkuar të hiqet nga rendi i ditës duke kërkuar sqarime nga Bushati se pse ky projektligj paraqitet nga Ministria e Jashtëm dhe jo nga Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Punëve të Brendshme. Kreu i PBDNJ, Vangjel Dule ka replikuar edhe me kryeministrit Edi Rama në seancën e Kuvendit. Dule tha se në vitin 2011 u hoq e dhëna për përkatësinë etnike dhe i bëri thirrje qeverisë të heqë dorë nga kjo propagandë. Në replikën e tij, Rama tha se Dule thotë gjëra që ai s'i ka thënë kurrë. "Vangjel, ti e ke bërë rrugë të



më citosh gabim sa herë vë fjalën e mia në gojën tënde. Nëse nuk do të njihja, do mendoja se e ke nga mendjelehtësia, por duke të të njohur, ti je i qëllimshëm sa herë që më vë mua në gojë gjëra që unë s'i kam thënë kurrë. Së pari, ti je një minoritar dhe jo minoriteti. Evropa, Vangjel nuk është as kishë ku nuk vihet në diskutim Zotit, e as xhami ku nuk vihet në diskutim Allahu, është kontinenti ku ne jemi pjesë, fakti që nuk jemi në BE nuk na bën më pak evropianë dhe ne kemi të drejtën të themi për BE Vangjel dhe kjo nuk përbën mëkat e arsye që zotrore të vish këtu e të më vësh mua në gojë gjëra që s'i kam thënë kurrë. Mësoji këto gjëra. Së fundi, ligji është krenari për këtë Kuvend", tha Rama.



**Balla: Në 26 ditë  
Kuvend, Rama 109  
minuta diskutime,  
Basha 121**

Pas seancës së Kuvendit, për të sqaruar opozitën, kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla bëri të ditur se "në 26 ditët e para të Kuvendit të ri janë bërë 160 diskutime ose 2055 minuta. Nga këto, mazhoranca ka pasur 62 diskutime ose 781 minuta, ndërsa opozita 98 diskutime ose 1274 minuta. Kryeministri Edi Rama ka pasur 6 diskutime ose 109 minuta, ndërsa Lulzim Basha 7 diskutime ose 121 minuta. Dhe opozita qahet se po i mohet e drejta e fjalës", u shpreh Balla. Ndërsa më herët, pas ndërprerjes së parë të seancës së Kuvendit, Balla tha se PD po merr në qafë LSI-së me skenarin e bllokimit të seancave në parlament. "Uroj të mos kthehen në çadër të dyja bashkë. Kërkesa e PD dhe LSI për Byronë e Kuvendit është alibi për të shpëtuar flamurin e bllokimit të radhës", u shpreh Balla.



**Noka: Ruçi  
qëndrim harbut,  
i amnistion Ramës  
fjalorin e rrugës**

Deputeti Flamur Noka është braktisi dje mbledhjen e Byrosë së Kuvendit dhe deklaroi për gazetarët se është turp për një parlament të përjashtojë deputetin se kërkon të drejtën e fjalës dhe të amnistojë kryeministritin që përdor fjalor rrugë në Kuvend. Ai pranoi se i ishte drejtuar kreu të qeverisë me fjalën "rrugac", por u justifikua se ishte Rama, ai që sulmoi me fjalor rrugë ish-kryeministritin. "E vetmja gjë që bëra më tepër është se insistova të kem të drejtën e fjalës, sepse dëgjova unë dhe gjithë të tjerët një kryeministër në sallë që fliste me një zhargon rrugëçor, të denjë për rrugë, jo për sallën e Kuvendit. Kërkova fjalën për procedurë që t'i kërkoja kryetarit të Kuvendit që t'i tërhiqte vëmendjen kryeministrit të mos fliste në sallën e parlamentit me zhargon rrugë", tha Noka.



Valentina Madani

**O**pozita blloko dje sër ish foltoren e Kuvendit. Shkak u bë ndërprerja e fjalës së ish-kryeministrit Sali Berisha dhe refuzimi i kërkesës së deputetit demokrat Flamur Noka nga kryeparlamentari Gramoz Ruci, për marrjen e fjalës për procedurë. Teksa ish-kryeministri Sali Berisha po fliste nga foltorja e Kuvendit, duke e quajtur sjelljen e pr'ligjit për pakicat në shkëlqje të hapur të Kushtetutës dhe një gjë fare qesharake, që sipas tij bëhet për rivalitet mes klaneve mafioze në qeveri, ka reaguar pa mikrofon nga vendi i kryeministrit Rama. Ai ka përmendur fjalën 'e dhje.' dhe 'i rrjedhur' kur fliste Berisha. Kaq mjaftoi që deputetët e PD-së, të nisnin protestën në sallë, deri në bllokimin e foltores. Ruçi ndërkohë i hoqi fjalën Berishës i cili u ul në vend duke lajmëruar deputetin e LSI-së Shezai Rrokaj të marrë fjalën në foltore. Por z.Noka e

Tensione në Kuvend, kryeministri pa mikrofon fyen Berishën: E dhje..., i rrjedhur

# Opozita bllokon foltoren, Kuvendi mblidhet sot serish

## Noka-Ruçit: Rrugaç, ti je xhandar



Protesta e opozitës dje në Kuvend

**SALI BERISHA**  
Ish-kryeministri Berisha akuzoi kreun e Kuvendit Ruçi se po shkatërron parlamentin. "Ministri i fundit i policisë kriminale terroriste të diktaturës hoqiste ka marrë përsipër një mision, shkatërrimin përfundimtar të institucionit qendror të demokracisë që është parlamenti. Nuk ka ndodhur kurrë në histori që në mënyrë kaq të vendosur të mos respektohet e drejta e fjalës për procedurë", deklaroi z.Berisha.

**REAGIMI**  
**Vasili: Rama na çau dërrasat përditë, mik i oligarkëve**

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili akuzon kryeministrin Rama se ka në kokë vetëm ligjin e agjitation dhe propagandës dhe të internim e debimeve. Në një status në "Facebook", Vasili shkruan: "A ka turp ky shkollëpaku? Kryeministri shkollëhëq na çau dërrasat përditë, që mëdeme ai respekton rregullat, ligjet edhe për preshin, lakrën dhe sallatën etj etj. Po mësuesen në Kamëz, Hamide Qemirani, banditizimi i qeverisë e zbon nga puna, me çfarë rregulla a ligje e heq ky kryeministër? Jo, mor jo, ky shkollëhëq ka në kokë vetëm ligjin e agjitation dhe propagandës dhe të internim debimeve, s'kaky asnjë lidhje as me demokracinë e as me pluralizimin. Këtë nuk e zë gjumi vetëm që të lulëzojnë kanabis dhe koncesionet, se shteti ligjor na la shëndën. Shteti ligjor s'ka hiç të bëjë me potturet e këtij, që kutërbojnë nga kanabis. Mësuesja Hatixhe dënohet pa ligj nga kanabisti në krye të qeverisë. Ky është morali i histerive mediatike të shtetit që ka rënë".

### "Fyeu ish-kryeministrin, Ruçi rrezon kërkesën e opozitës"

## Berisha bën bashkë PD-LSI, kërkojnë largimin e Ramës

**P**D, LSI dhe PR kërkuan dje përjashtimin e kryeministrit Edi Rama nga seanca plenare për 10 ditë, me pretendimin se ky i fundit ofendoi sot në sallë ish-liderin e demokratëve Sali Berisha, duke i thënë 'i rrjedhur'. PD, LSI dhe PR kanë mblodhur firmat për kërkesën për përjashtimin e Ramës. Deputetët e opozitës pohan se kryeministri me një gjuhë vulgare fyeu Berishën, ndërsa atij i doli në mbrojtje Flamur Noka. Deputeti i blloko foltoren, ku i bënte thirrje Ruçit që t'i jepej fjalë Berishës. Fill pas këtyre momenteve të tensionit, kryeparlamentari Ruçi e pezulloi atë ditën e djeshme nga Kuvendi, rifilloi në orën 17:00 por u shty për ditën e sotme në orën 8:30. Për kërkesën e fundit, Ruçi tha se është e pabazuar dhe nuk e merr në konsideratë, ndërsa njoftoi mblledhjen e Byrosë së Kuvendit në orën 19:00 për Nokën. "Është bërë kërkesë nga 8 deputetë të mazhorancës që kërkojnë thirrjen e Byrosë së Kuvendit për të analizuar qëndrimin ndaj deputetit Flamur Noka, njëherësh është bërë një kërkesë kryetarit të Kuvendit nga 9 deputetë të grupimeve të ndryshme të opozitës për të marrë masa ndaj deputetit Edi Rama për seancën e sotme. Pasi u konsultua dhe pashë të zbardhur procesverbalin e seancës nuk mund ta marr në konsideratë. Njoftoj që Byroja e Kuvendit do të thirret sot në 19:00", deklaroi z.Ruçi.



**KWRKESA**  
Kërkesa për përjashtimin e Ramës është firmosur nga kryetarët e grupeve parlamentare të opozitës, Spaho, Vasili dhe Mediu, pasi sipas tyre kryeministri ofendoi Berishën dhe opozitën me një fjalor vulgar dhe të papranueshëm.

kërkoj fjalën me pretendimin se gjatë fjalës që mbajti z. Berisha, kryeministri Rama po fliste pa mikrofon dhe i adresoi fjalë fyese ndërkohë që opozita rrethoi foltoren. Bllokimi i saj e detyroi kryeparlamentarin Ruçi që ta përjashtoj nga seanca plenare deputetin Noka dhe të ndërprejë për pesë minuta punimet e Kuvendit. Me rinisjen e seancës asgjë nuk ndryshoi, ç'ka e detyroi Gramoz Ruçin ta shtyjë për në orën 17:00 seancën plenare. Menjëherë pas ndërprerjes së punimeve deputetët e Partisë Demokratike, ata të LSI-së dhe PR-së kërkuan përjashtimin e kryeministrit Rama nga punimet e parlamentit, me të njëjtin argument me të cilin kërkoj fjalën për procedurë demokratike Noka. Pas ndërprerjes së fjalës së Berishës në foltore, Noka kërkoj të reagojë për procedurë, pasi sipas tij Rama ofendoj ish-kryeministrin, por Ruçi nuk pranoi duke refuzuar që t'i japë fjalën. Kaq mjaftoi që situata të precipitonte në sharje dhe ofendime nga Noka, që iu drejtua Ruçit me fjalët rrugaç, Ruçi e përjashtoi nga seanca, ndërsa opozita bllokoj foltoren duke bërë që të ndërpritet seanca plenare. Në kundërpërgjigje të kërkesës së opozitës, socialistët kërkuan thirrjen e Byrosë për përjashtimin e deputetit Flamur Noka me 10 ditë nga punimet e Kuvendit. Edhe pse seanca plenare u shty për në orën 17:00 të pasdites, deputetët e opozitës qëndruan të ngujuar në sallën e parlamentit. Seanca e pasdites zgjati vetëm 8 minuta. Ruçi kërkoj largimin e Nokës nga Kuvendi, ndërkohë që ky i fundit ka thënë se do të iki në momentin që kryeministri të

### DEBATI QË SOLLI SHERRIN DJE NE KUVEND

- Sali Berisha mban fjalën për projektligjin e sjellë nga Ministria e Jashtme për pakicat, duke e quajtur sjelljen e pr'ligjit për pakicat në shkëlqje të hapur të Kushtetutës dhe një gjë fare qesharake, që sipas tij bëhet për rivalitet mes klaneve mafioze në qeveri,
- Edi Rama nga vendi pa mikrofon shprehet nëpër dhembë: I rrjedhur, e dhj.....
- Gramoz Ruci i heq fjalën Berishës: Kaloi koha, zoti Berisha, mbaroi koha, ulu.
- Sali Berisha ulet në vend.
- Flamur Noka flet nga vendi: Dua fjalën për procedurë
- Gramoz Ruci: Ulu, mos fol, nuk ka procedurë
- Flamur Noka: Na tregon ti procedurat, ca kujton ti, xhandar. Ti je rrugaç.
- Gramoz Ruci: Të tërheq vëmendjen, mos fol, lerë deputetin të flasë (për Xhezair Rrokaj)
- Flamur Noka: Fjala për procedurë, rrugaç, jep fjalën, xhandar
- Noka-Ramës: Ky ke b"thë ti t'i heqësh fjalën Sali Berishës
- Gramoz Ruci: Atëherë, të tërheq tri herë vërejtjen, po shkel rregulloren, me detyrove të marr masë, je i përjashtuar nga seanca, 5 minuta pushim deri sa të liroh foltoren.
- Opozita ngujohet në Kuvend deri në 17:00 kur rifillon seanca parlamentare.
- Gramoz Ruci: I bëj thirrje deputetit të lirojë seancën. Zoti Noka do lironi sallën?
- Flamur Noka: Të largohet edhe ai deputeti atje (drejton gishtin nga z.Rama)

lirojë vendin. Që në nisje të seancës kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi, bëri një përmbledhje të minutave të vëna në dispozicion të mazhorancës dhe opozitës për të folur, duke hedhur poshtë pretendimet e këtyre të fundit se nuk kanë hapësirë për të folur. Më pas ai i njohte me dy kërkesat e marra, njërin nga mazhoranca për mblledhjen e Byrosë për Flamur Nokën pas bllokimit të foltores dhe të tjetrin nga opozita për përjashtimin nga seanca të kryeministrit

Rama. Gramoz Ruçi më pas i bëri thirrje deputetit demokrat të lirojë sallën. "I bëj thirrje deputetit të lirojë seancën. Zoti Noka, do lironi sallën?", tha z.Ruçi. Por z.Noka nga karrigia e tij duke i drejtuar gishtin kryeministrit Rama u shpreh: "Të largohet edhe ai deputeti atje". E ndërsa hasi në refuzimin e tij për të dalë jashtë, Ruçi mbylli punimet e Kuvendit duke njoftuar serish sot seancë plenare. Seanca do të nisë në orën 08:30 të mëngjesit.

## REFORMA ZGJEDHORE DIALOGU

FINANCIMI I PARTIVE/ Kreu i KQZ-së, Zguri: Lidershipi politik të tregojë shtetari

# "Zgjedhorja", KE: Dialog, zbatoni rekomandimet e Venecias dhe OSBE

*Verifikimi i parave të partive, kërkohet strukturë e posaçme*



Valentina Madani

Këshilli i Europës kërkon dialog dhe konsensus për realizimin e reformës zgjedhore duke siguruar mbështetje Shqipërimë në realizimin e saj. Por KE kërkon nga partitë politike implementimin e plotë të rekomandimeve të OSBE/OHIR dhe Komisionit të Venecias. Në workshopin e zhvilluar djete më temë "Struktura e

mbikëqyrjes së financimit të partive politike dhe të fushatave zgjedhore", shefi i zyrës së KE-së, Claus Neukirch, insistoi që reformat të zhvillohen nën frymën e dialogut dhe kompromisit. "Dëshirojmë të shohim një proces reformash të ushqyer nga dialogu dhe kompromisi, duke marrë parasysh rekomandimet e Këshillit të Evropës, OSBE-ODHIR dhe Komisionit të Venecias. Përkundër ndryshimeve ligjore të paraqitura në maj pas marrëveshjes politike, reko-

mandimet duhet të zbatohen plotësisht. Këshilli i Evropës është shumë i përkushtuar për të mbështetur reformën zgjedhore. Ne do të kontribuojmë në forcimin e legjislacionit për partitë poli-

tike dhe financave të fushatave zgjedhore", deklaroi Claus Neukirch. Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Klement Zguri, parashtrroi nevojën e përmirësimit të kuadrit lig-

zor për financimin e partive politike, ndërsa siguroi rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe OSBE-ODHIR janë prioritet i institucionit që drejton. "Sigurisht që ne që jemi mbledhur këtu nuk mund të na lënë indiferentë, por, së pari, nuk duhet të lënë indiferentë ata që në fushatë hidhin "gurë" mbi njeri-tjetrin, partitë politike. Tani nuk është koha për të hedhur "gurë". Tani është koha për të ndërtuar "mur". Tani "muratorët" e reformës nuk mund ta konsiderojnë

përmirësimin rrënjësor të kuadrit ligjor për financimin, çështje të dorës së dytë. Tani është koha që lidershipi politik të tregojë shtetari dhe ta deklarojë reformën e financimit dhe transparencën e fondeve e të shpenzimeve çështje prioritare", u shpreh kreu i KQZ-së Klement Zguri. Cilësia e reformës së ardhshme zgjedhore, përfundoi Klement Zguri, matësin e vet e ka tek transparenca financiare, por edhe shpenzimet e fushatës që do të pasqyrojë.

### KLEMENT ZGURI

"Muratorët" e reformës s'mund ta konsiderojnë përmirësimin rrënjësor të kuadrit ligjor për financimin, çështje të dorës së dytë. Është koha që lidershipi politik të tregojë shtetari dhe ta deklarojë reformën e financimit dhe transparencën e fondeve e të shpenzimeve çështje prioritare", - u shpreh z.Zguri.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Institucioni i Presidencës

Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, shpall vendet vakante për

## 7 (SHTATE) KËSHILLTARË LIGJORË DHE 3 (TRE) KËSHILLTARË EKONOMIKË.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data **6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017** në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkeses nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë", Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 Nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në adresën [info@kpa.al](mailto:info@kpa.al). KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë) dhe pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike**, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë) dhe pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".



Workshopi me temë "Struktura e mbikëqyrjes së financimit të partive politike dhe të fushatave zgjedhore"

**RAPORTET ME SERBINË**

"Presidenti Vuçiç ishte i pari që vizitoi Shqipërinë pas 60 vitesh. Po ngremë në këmbë një plan ambicioz për të hequr tarifat doganore, lehtësuar tregtinë dhe hap pas hapi, kjo do të na ndihmojë të tejkalojmë dallimet mes nesh, të zgjidhim çështjet tona. Kosova është një pikë e mosmarrëveshjes, por arrijmë ta menaxhojmë", -tha dje, Rama.

Intervista për "La Repubblica", kryeministri: Hyrja në BE mund të garantojë paqe

# Edi Rama: Kemi shkatërruar fushat e mbjella me kanabis

"Shqiptarët, populli më europianist në Evropë"



komunist. E kuptojmë deri në fund vlerën e BE-së, një aleancë e lindur për të sjellë paqe mes vendeve që kanë luftuar me shekuj mes njëri-tjetrit, një aleancë që ka pasur një sukses të jashtëzakonshëm, edhe pse sot strukturat e saj duhet të modernizohen. Por, të vësh në diskutim mënyrën sesi funksionon BE-ja, është e dobishme; të vësh në diskutim objektivat e saj strategjike do të thotë të mos njohësh historinë, të dish se asgjë nuk është një herë e përgjithmonë. Besoj se BE-ja do të dijë të bëjë dallimin mes krizave që kanë të bëjnë me rritjen e saj dhe braktisjes së idealeve dhe parimeve të saj strategjike. Projekti i BE-së është absolutisht i vlefshëm si horizont paqeje për të gjithë ne.

**sa të arrijë të bëjë lëvizje të tilla?**

Nuk do e fusja sjelljen e tyre në fushën e "fiksimeve". Është siç thashë, manovra që do të sabotonte hyrjen e Malit të Zi në NATO ishte pjesë e kësaj loje gjeostrategjike që përpiqet t'i ndryshojë rrjedhën vendeve tona. Ne nuk e duam këtë. Për Moskën ishte e rëndësishme të thyente unitetin e vendeve të Ballkanit që në bregdetin Adriatik janë tashmë të gjithë anëtarë të NATO-s.

**Nuk mendoni se SHBA-ja po heq dorë nga një rol i fortë në rajon?**

Roli i saj është thelbësor.

Pas 40 vitesh komunizmi totalitar shqiptar dhe fiksimi antiimperialist e anti-amerikan, populli shqiptar zhvilloi një aspiratë të thellë për vlerat liberale amerikane dhe europiane dhe roli i ekuilibrit të Shteteve të Bashkuara në zonën tonë është i domosdoshëm.

**Ju e keni thënë disa herë se pas luftërave ballkanike në vitet '90-të, vendet e rajonit po shndërrohen nga "armiç në fqinj". Çdo të thotë kjo? Çfarë marrëdhënie keni me Serbinë?**

Katër vite më parë, në vizitova Beogradin si kryeministri i parë shqiptar që prej 1946-ës; Presidenti Vuçiç ish-

te i pari që vizitoi Shqipërinë pas 60 vitesh. Po ngremë në këmbë një plan ambicioz për të hequr tarifat doganore, lehtësuar tregtinë dhe hap pas hapi, kjo do të na ndihmojë të tejkalojmë dallimet mes nesh, të zgjidhim çështjet tona. Kosova është një pikë e mosmarrëveshjes, por arrijmë ta menaxhojmë. Mund të bashkëpunojmë.

**Meqë u përmend Kosova, çfarë mendoni për ndarjen e Katalonjës?**

Nuk më pëlqen kur dikush nga jashtë flet për punët e një vendi tjetër. Por sigurisht preferoj proceset politike që bashkojnë, që afrojnë.

**Shumë flasin për Lazaratin, fshatin ku kultivohej marijuanë, ekzistojnë akoma këto oaze të kimit në Shqipëri?**

Me ndihmën e qeverisë italiane, të Guardia di Finanza, kemi kontrolluar javë pas javë situatën në Lazarat dhe në zonat ku organizatat kriminale vepronin. Po presim raportin e fundit të Guardia di Finanza, por po ju them se këto fusha të paligjshmërisë totale janë shkatërruar.

**Kreu i qeverisë përfaqëson edhe drejtuesit e administratës së qarkut**

## Zbardhet axhenda e mbledhjes dyditore, të qeverisë në Vlorë



Qeveria do të mbledhet sot në Vlorë, pas dy takimeve që janë zhvilluar në Llogora dhe në Velipojë. Sipas axhendës së publikuar, fillimisht kryeministri, së bashku me deputetët e zonës dhe ministrin e Bujqësisë do të inspektojë investimet në rehabilitimin e skemës së ujitjes në Krutje të Lushnjës. Në orën 13:00 është planifikuar një drekë me ministrat dhe mbledhja e qeverisë pritet të fillojë në orën 16:00 në Pallatin e Kulturës. Do të jetë zv. kryeministrja Senida Mesi, e cila do të japë vendimet e mbledhjes për median. Në fund të ditës së parë të mbledhjes është parashikuar një darkë e kryeministrit me kryebashkiakët, deputetët, kryetarët e këshillave e prefektin e Vlorës. Ndërsa ditën e shtunë mbledhja e kryeministrit dhe ministrave do të jetë me të gjithë drejtuesit e administratës qendrore në qarkun e Vlorës dhe do të transmetohet live nga televizionet. Përveç takimeve në Vlorë, ministrat do të shkojnë edhe nëpër fshatra ku do të takohen nga afër me banorët, por nuk do të mungojnë as prezantimet e hapura.

**Pse Ballkani vazhdon të jetë në objektivin e Rusisë, Turqisë, fuqive autokratike që duket se luajnë këtu një pjesë të rivaliteteve të tyre gjeopolitike?**

Ka një dallim të rëndësishëm, në perceptimin tonë, mes Turqisë dhe Rusisë. Ne shqiptarët e shohim Turqinë si një shtet të rajonit, që po përpiqet të luajë rolin e tij, pa u munduar t'u imponojë asgjë vendeve të Ballkanit. Është një vend i lidhur me perspektivën euroatlantike. Rusia ka lidhje me Serbinë, me botën sillave, por e përdor këtë lidhje sikur të ishte një gur shahu në fushën e interesave të saj gjeostrategjike; luan në Ballkan për të garantuar dicka tjetër, në nivel global, në marrëdhëniet me Europën dhe Shtetet e Bashkuara.

**Moska luajti rol në përpjekjen për të eliminuar kryeministrin e Malit të Zi, disa muaj më parë. Mendoni se Rusia është kaq e fiksuar nga roli i saj në rajon,**

**DRAFTAXHENDA E MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË QARKUN VLORË, 13-14 TETOR 2017**

**13 TETOR**

- ▷ 10:30 Nisja për në Vlorë
- ▷ 11:30 Inspektim i investimeve për reabilitimin e skemës së Ujitjes, Dega e Krutjes (në dalje të Lushnjës, Klubi i Shofertit, KM, Niko, deputetët e zonës)
- ▷ 13:00 Drekë me ministrat në Vilën Qeveritare Vlorë
- ▷ 16:00 Mbledhje e Këshillit të Ministrave (Pallati i Kulturës)
- ▷ 16:30 Njoftim në media i vendimeve të qeverisë nga zv.km Senida Mesi (Pallati i Kulturës)
- ▷ 18:00 Konsultimi Publik për Buxhetin 2018 me pjesëmarrje të qytetarëve, shoqërisë civile dhe sipërmarrjes për Draft Buxhetin 2018 (Holli i Universitetit Ismail Qemali) LIVE.
- ▷ 20:00 Darkë - Çdo ministër një tryezë me 10 të ftuar të dalluar nga sektori i tij. KM me kryebashkiakët, deputetët, kryetarët e këshillave, prefektin (Restorant Mira Mare)

**14 TETOR**

- ▷ 8:00 Çdo ministër mëngjes pune me drejtuesit e institucioneve të varësisë në qark

- ▷ 9:00 Mbledhje e KM dhe ministrave me të gjithë drejtuesit e administratës qendrore në qark. LIVE (Pallati i Kulturës)
- ▷ 10:30 Dëgjësje me prindërit për "Plan-et e bashkëhartuara me prindërit në shkolla" (KM, Nikolla, Kryetari Bashkisë-shkolla TBC) LIVE. Shoqëron ministrin, Dep. Vilma Bello
- ▷ 12:00 Çdo anëtar i qeverisë nisjet në fshatra të ndryshëm për takime në sektorët përkatës dhe kafe/dreke me banorë të fshatit.
- ▷ KM vizitë në Kaninë dhe drekë me një familje në fshatin e Kaninës. LIVE (13:00)
- ▷ 15:30 Inspektim i punimeve në nën-stacionin e Orikumit (KM, Gjinkuri, Leli, Edmond Leka)
- ▷ 16:00 Vizitë në Parkun Arkeologjik të Orikumit (KM, Kumbaro, Gjinkuri, Leli, Edmond Leka)
- ▷ 17:00 Takim i qeverisë dhe pushtetit vendor në Qark, kryetarët e bashkive, administratorët dhe deputetët Socialistë. (Pallati Kulturës) LIVE.
- ▷ 18:30 Kthimi në Tiranë

Kryetarja e LSI-së denoncon: Kryeministri, kryetar i 4 klaneve mafioze

Kryemadhi: Nëse nuk ikën Edi Rama, ky vend do të shikojë ditë më të këqija



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi deklaroi dje se, "nëse nuk ikën Edi Rama, ky vend do të shikojë ditë edhe më të këqija".

Kryeministri Berisha. Kryemadhi e ka quajtur mazhorancën si arrogante dhe tha se Ruçi ka bërë një sjellje jonormale gjatë seancës në Kuvend.

kujton Kim Jong Un, po që është version i gjatë, që thotë e kam sharë nëpër dhembë. Çdo ditë e më shumë po shkojmë drejt një diktature".

ganizuar, e gjithë mafies shqiptare dhe kryetari i katër klaneve mafioze është Edi Rama. E pyetur nëse mban përgjegjësi LSI-ja, e cila ka qenë pjesë e qeverisë për gjendjen e kriminalitetit në vend, Kryemadhi tha: "Po sigurisht që mbaj përgjegjësi, por nuk është maksimale."

opozita, ajo u shpreh: "Ne nuk do rrimë të shkallët e Kuvendit. Ne do të sinkronizohemi. Jam e bindur që zoti Basha nuk do të pranojë të qeverisë nga bandat e krimi i organizuar. Edi Rama, kjo është kambanë alarmi për të gjithë shqiptarët! Ky vend po masakrohet. Bandat po e marrin peng këtë vend".

Rama, kjo është kambanë alarmi për të gjithë shqiptarët! Ky vend po masakrohet. Bandat po e marrin peng këtë vend".

Presidenti takohet me Haradinajn, Veselin dhe krerët e partive

Meta: Duhet dialog konstruktiv i të gjitha forcave për ardhmërinë e Kosovës

Kreu i shtetit nderon Ibrahim Rugovën e Adem Jasharin

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta vijoi dje vizitën në Kosovë me një bisedë me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinajn, ku të pranishëm ishin edhe zëvendëskryeministrat Fatmir Limaj, Enver Hoxhaj, Dalibor Jevtić dhe Dardan Gashi.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj

nevojën e vazhdim të dialogut me Kosovës dhe Serbisë, Presidenti Meta u shpreh se vijimi dhe konkretizimi i këtij dialogu nuk është i rëndësishëm vetëm për këto dy vende, por edhe për të gjithë rajonin, sigurinë dhe të ardhmen e tij.

e iniciativave të ndryshme në funksion të avancimit të agjendës evropiane dhe euroatlantike të vendit. Gjatë ditës së dytë të vizitës shtetërore, Presidenti i Republikës, Ilir Meta u takua me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri; me kreun e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa si dhe përfaqësuesin e Listës Serbe, Slavko Simić.

te të Kosovës. Në takimim me Vetëvendosjen, Presidenti Meta i përgjosi për rezultatit e arritur në zgjedhjet e fundit dhe theksoi rëndësinë e jashtëzakonshme që ka roli i opozitës në demokraci për të rritur përgjegjësinë dhe cilësinë e qeverisjes në vend dhe për të afruar një alternativë më të mirë për të ardhmen.



Nderimi

RUGOVA

Presidenti Ilir Meta nderoi dhe vlerësoi jetën, veprën e paharruar dhe kontributet madhore të Ibrahim Rugovës, si dhe përkujtoi sakrificat sublime të familjes Jashari për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

DELEGACIONI

Bushati takon presidenten e Asamblesë së KE, vlerësohen reformat

Kryetari i delegacionit të përhershëm të Kuvendit të Shqipërisë, Ervin Bushati, u takua dje me presidenten e sapozgjedhur të Asamblesë Parlamentare, të Këshillit të Evropës, Stella Kyriakides. Ai shprehu bindjen se Presidenca e Kyriakides do të kontribuojë në kapërcimin e vështirësive, duke punuar bashkërisht për forcimin dhe promovimin e vlerave dhe përbashkëta, demokracisë, të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës.

SHPLLJE ANKANDI
Shoqëria përbërësi "Corrector" shpk, zivillon ankanidn e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, - Pasuria Njësi me Nr. 3/417- N8, Zona Kadastrale 2364, me sipërfaqe 97.2 m², ndodhur në Laç;

SHPLLJE E ANKANDIT TË PARË
Permbarusi Gjyqësor Rrok Deda me adresë Rruga Sulejman Delvina Nderatesa 51, Hyrja 9, App. Nr. 1, pranë Hotel "Diplomat" Tiranë, ofron shpalljen e ankandit të trete për aksionet e shoqërisë "ENARVI" shpk vlefshme 12.85% e aksioneve të vilat janë pronësi të z. Zena Troka me çmim të shitjes në ankannd në vlerën 10.691.856 (dshjetë milion e gjashtëqindëntëdhjetë mijë e tetëqindëspesdhjetëgjashtë) lekë Personat e interesuar për të marrë pjesë në ankannd , duhet të paguajnë 10% të vlerës në llogarinë me nr. 0000 360 171 në emër të Rrok G. Deda PF në bankën Raiffeisen. Ankanndi mbyllet me dt. 16.10.2017 në ora 16:00

PERMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT ERMIR GODAJ
Permbarusi gjyqësor privat Ermir Godaj zivillon ankanndin për shitjen e pasurisë së paluajtshme "Apartament", me Nr Pasurie 5230-1-8, Zona Kadastrale 0513, Wt.14, Fq.49, me sipërfaqe 52.02 m², të ndodhur në P.Saraj 17, Pall 97/81, Shk.1, Ap.8, Durres, për shitje dhe detyrimin në favor të kreditit ProCredit Bank Sh.a., për shumën 1947880 Shq (në milion e nentëqind e dyzetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë pike pesëdhjetë e tetë) Leka dhe 33.6 (tridhjetë e tre pike gjashtë)Euro.

Konsultimi me biznesin, problemet e sipërmarrjes dhe fushatat anti-informalitet

# Tatimet: Deklaroni pagat e plota, bizneset: Reduktoni kontrollet

Drejtorja e Tatimpaguesve të Mëdhenj shpjegon mënyrën e kontrollit

Ornela Manjani

Në kulimin e fushatës "anti-informalitet 3" tatimet dhe bizneset janë ulur në një tryezë për të konsultuar shqetësimet e të dy palëve. Gjatë një takimi të organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, drejtoresha e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, Enkelejda Pipa, ka shpjeguar për bizneset mënyrën se si do të ushtrohen kontrollet dhe çfarë kërkohet nga ata për të qenë më bashkëpunues. Tashmë kontrollet janë organizuar dhe do të zhvillohen në dy aspekte: verifikime në vend dhe kontroll nga zyra. Por kontrollet tatimore për tatimpaguesit e mëdhenj do të realizohen më së shumti nga zyra, në bazë të analizës së riskut. "Shtylla e parë ka të bëjë me shërbimin dhe informimin e të gjithë tatimpaguesve, përfshirë ata tatimpagues të mëdhenj apo edhe të tjerë të mesëm dhe të vegjël. Ky plan veprimi, në fakt, do organizohet pikërisht nëpërmjet këtyre takimeve që ne do të bëjmë bashkë, nëpërmjet informimeve, nëpërmjet njoftimeve që ju dërgojmë. Besoj që ato kanë arritur tashmë të ju. Mund të jeni të informuar për këtë. Mendohej, në fakt, që të hartojmë rregulla, të shkruajmë ato që ndoshta ligji i ka të shkruar, por në mënyrë të përmblodhur të ju vijmë më qartë dhe herë pas here t'ju dërgojmë në adresën tuaj elektronike apo edhe me shkrim, në mënyrë që padiskutim gjatë kësaj faze të jeni të informuar, por edhe të dini se ku duhet të keni kujdes që ligjin ta zbatoni korrekt", tha Pipa.



Kryetari i Dhomës së Tregtisë së Tiranës, Nikolin Jaka dhe drejtoresha e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, Enkelejda Pipa

## KËRKESAT NË PROTESTË Biznesi i madh: Përfshinë në TVSh bizneset e vogla

Përfaqësues të biznesit të madh kanë marshuar në bulevardin e kryeqytetit me tullumbace ku shkruhej "Jo, informalitetit në biznes". Marshimi është organizuar nga "Bashkimi Tregtar i Shqipërisë", në kuadër të ditës "Për një ekonomi më të drejtë", që sipas organizatorëve synon të sensibilizojë opinionin e gjerë publik ndaj efekteve negative të fenomenit të informalitetit, dhe nevojës për të luftuar bashkërisht çdo formë të tij e kudogjendur në ekonominë shqiptare. Bizneset e mëdha gjithnjë e kanë kërkuar dhe mbështetur futjen e subjekteve të vogla në TVSH, si një mjet për të nxitur faturimin në të gjithë zinxhirin e tregimit dhe shërbimeve. Qeveria e ka deklaruar tashmë se e ka në plan, duke shtrirë TVSH-në nga zero për të gjitha bizneset, me përjashtim të disa kategorive si zejtarët

### BIZNESET

Kryetari i Dhomës së Tregtisë së Tiranës, Nikolin Jaka, duke treguar gadishmërinë e këtij komuniteti, tha se janë vetë ata që kanë kërkuar këtë për të rritur konkurrencën në treg.

"Mund të ndryshojë sjellja dhe komunikimi, por, nga ana tjetër, mund të jetë dashakeqësi brenda, brenda secilit inspektor. Ne mendojmë dhe sugjerojmë që gjithmonë qasja e mbajtjes së krahut nga ana e sipërmarrjes është një domosdoshmëri sidomos në kushtet aktuale, ku ne pretendojmë të rrisim dhe të përmirësojmë dialogun e publikut me privatit", -u shpreh Jaka. Një ndër problematikat sipas biznesit është se kjo fushatë është ndërlikuar edhe me shtrirjen e TVSH-së te biznesi i vogël, çka është një paqartësi e madhe.

"Për fushatën e biznesit të vogël dhe përfshirjen e TVSH-së, kemi qenë ne nga të parët, kemi dy vjet që ia kemi propozuar me shkrim

## Qeveria akumulon borxhe, në gjashtë muaj 1.5 miliardë lekë detyrime

Sipërmarrjet private vazhdojnë të mos paguhen për sponë e bëra apo shërbime të kryera, nga administrata shtetërore. Pothuajse të gjitha dikasteret qendrore kanë krijuar detyrimeve të prapambetura. Edhe pse në ligjin e buxhetit, por edhe në strategjinë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura theksohet moskrijimi i borxheve të reja, duket se kjo nuk po funksionon. Fondet buxhetore duhet të disbursoheshin sipas projekteve të parashikuara më parë. Ndërkohë në raportin e fundit të FMN i "tërhiqet vërejtje" qeverisë për moskrijimin e detyrimeve të reja. Referuar të dhënave më të fundit të Ministrisë së Financave, rezulton, se vetëm për periudhën maj-qershor 2017, vlera e detyrimeve të prapambetura, të krijuara nga institucione të ndryshme arrin në 1.5 miliardë lekë.

### DETYRIMET

- ↳ Ministria e Transportit dhe Infrastruktura - 943.8 milionë lekë
- ↳ Ministria e Arsimit dhe Sportit - 1 milion lekë
- ↳ Ministria e Drejtësisë - 83.1 milionë lekë
- ↳ Ministria e Shëndetësisë - 63.9 milionë lekë
- ↳ Ministria e Punëve të Brendshme - 143.1 milionë lekë
- ↳ Ministria e Zhvillimit Ekonomik - 0.2 milionë lekë
- ↳ Ministria e Punëve të Jashtme - 12.1 milion lekë
- ↳ Ministria e Financave - 154.3 milionë lekë
- ↳ Ministria e Zhvillimit Urban - 45.9 milionë lekë
- ↳ Ministria e Mjedisit - 74.7 milionë lekë
- ↳ Ministria e Integritetit Europian - 0.6 milion lekë
- ↳ Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve - 3.9 milionë lekë

Ministrisë së Financave, që të bëhet. Edhe ajo është prapë pjesë që nuk merret vesh ose që nuk është e konsultuar me ne", tha Bujar Bendo. Komuniteti i biznesit e ka mbështetur fushatën ndaj informalitetit edhe pse shpesh kanë denoncuar arbitraritetin e inspektorëve tatimore. Ndërkohë niveli i informalitetit në ekonominë shqiptare vazhdon të jetë i lartë.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve UPS të dhomave të serverave të Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 2,700,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve UPS të dhomave të serverave të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 2 Nëntor 2017, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Upgrade i sistemit të Regjistrimit të Kredive të Bankës së Shqipërisë".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur ndërkombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 30,000,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Upgrade i sistemit të Regjistrimit të Kredive të Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 12 Dhjetor 2017, ora 9:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

## MASAKRA NE LUSHNJE AUTORET

Merret në mbrojtje shënjestra e atentatit. Nipi i Aldo Bares: S'isha në vendngjarje

# Masakra në Lushnjë, gjurmët e gishtave e pamjet filmike zbulojnë dy autorët

Shpallen në kërkim Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili

### LUSHNJË

Vetëm pak orë pas masakrës së ndodhur në vendin e quajtur "Ura e Përroit" në qytetin e Lushnjës, ku u ekzekutuan me breshëri kalashnikov 22-vjeçari Jurgen Hoxha dhe 23-vjeçari Zamir Latifi si dhe u plagos miku i tyre, Marjus Xhepeh-xhiu dhe një kalimtar i rastit, policia ka mundur të identifikojë 2 persona si autorë të kësaj ngjarjeje, që tronditi jo vetëm banorët e zonës, por të gjithë opinionin publik. Bëhet fjalë për Laert Haxhiun dhe Orges Bilbilin (persona me precedentë penalë), të cilët janë shpallur në kërkim. Ata akuzohen për veprat penale: "Vrasje e kryer në bashkëpunim", "Vrasje e mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim" si dhe për "Mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarakë". Mësohet se dy autorët e dyshuar u zbuluan nga pamjet filmike të bizneses pranë vendit të ngjarjes në lagjen "Loni Dhamo" dhe gjurmët që u gjetën në makinë, ndërsa po kërkohen në katër rrethe. Pas hetimeve të kryera, dyshohet se shënjestër e atentatit ka qenë Xhulio Shkurti, djali i vëllait të Aldo Bares (Alfred Shkurti). Ky i fundit mbeti i plagosur më 25 shtator të vitit 2016 së bashku me Saimo Xhelium, në të njëjtin vend ku ndodhi masakra. Një ditë pas atentatit, policia ka shoqëruar e marrë në pyetje Xhulio Shkurtin. Ky i fundit (kushëri me viktimit Jurgen Hoxha) ka deklaruar se në kohën kur ndodhi ngjarja nuk ishte në lokal, por tek berberi. Burime nga policia pohuan se ai ka ikur nga lokali 10 minuta para atentatit.

### ATENTATORËT

Vrasja e dyfishtë e ndodhur rreth orës 18:00 të së mërkurës në Lushnjë ka alarmuar policinë, e cila menjëherë ka nisur hetimet intensive për identifikimin e vënien në pranga të autorëve të krimit. Policia e Lushnjës në bashkëpunim me atë të Fierit kanë mundur të identifikojnë në kohë



Autori i dyshuar i atentatit, Laert Haxhiu



I kërkuari, Orges Bilbili

### XHULIO SHKURTI

Burime nga policia dje bënë me dije se shënjestër e atentatit të dy ditëve më parë ka qenë Xhulio Shkurti, nipi i Aldo Bares. Mësohet se në tavolinën ku po pinin kafe dy viktimat dhe i plagosuri Marjus Xhepeh-xhiu ka qenë edhe Shkurti. Ai është larguar nga lokali 10 minuta para se të bëhej atentati. Vetë i riu ka deklaruar në polici se në momentin kur ka ndodhur ngjarja, ka qenë tek berberi. Xhulio Shkurti i ka mbijetuar një atentati të bërë më 25 shtator të vitit 2016, ku mbeti i plagosur së bashku me shokun e tij, Saimo Xhelium.

## Reagon familja e Aldo Bares: Nipi s'ka lidhje me ngjarjen

### Policia e shoqëron Xhulio Shkurtin: Nuk isha në lokalin ku ndodhi atentati, por tek berberi

LUSHNJË - Pas shoqërimit nga policia të Xhulio Shkurtit (nipi i Aldo Bares) në lidhje me atentatin me 2 të vrarë dhe 2 të plagosur, kanë reaguuar familjarët kreut të bandës së Lushnjës. Të indinjuar, ata kanë deklaruar se nipi i tyre nuk ka asnjë lidhje me ngjarjen që tronditi qytetin e Lushnjës, ku u vranë Zamir Latifi dhe Jurgen Hoxha, i afërm i Xhulio Shkurtit. Sipas tyre, ata implikohen në çdo krim që ndodh në qytet pa pasur faj. "Nipi ynë s'ka asnjë

lidhje me ngjarjen. Na implikojnë pa lidhje në çdo krim në qytet. Media, politika, policia na implikojnë", kanë thënë të afërmit të Aldo Bares. Viktimat Jurgen Hoxha dhe Zamir Latifi njihen si miqtë e ngushtë të Xhulio Shkurtit, djali i vëllait të Aldo Bares (Alfred Shkurtit). Ky i fundit mbeti i plagosur më 25 shtator të vitit 2016 së bashku me shokun e tij Saimo Xhelium, 25 vjeç, në të njëjtin zonë ku ndodhi atentati i dy ditëve më parë.



rekord y persona, që pohohet se sharruan me plumba të rinjtë Jurgen Hoxha dhe Zamir Latifi. Sipas bluve, pas sinjalizimit për atentatin u organizua puna dhe u ngritën menjëherë pika kontrolli nëpër kryqëzimet, hyrjet dhe daljet e qytetit të Lushnjës. Ndërkaq, u njoftuan drejtoritë e policive: Fier, Berat e Durrës, me qëllim ngritjen e pikave të kontrollit në akset rrugore. Po të njëjtat burime pohuan se grupi hetimor ka shkruar menjëherë në vendin e ngjarjes, ku u kryen veprimet e mëposhtme: si këqyrja e vendit të ngjarjes ku u gjetën dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale gëzhoja si dhe një pis-

toletë, e cila dyshohet se i përkiste viktimit Zamir Latifi. Gjithashtu, grupi hetimor sekuestroi si prova materiale pamjet filmike në dy biznese në afërsi të vendit të ngjarjes, të cilat çuan në identifikimin e Orges Bilbili. Ndërsa, rreth orës 19:15 të së mërkurës, në parcelat e fshatit Çukas, në krahun e majtë të rrugës nacionale Lushnjë-Berat, u gjet i dëgjur një automjet tip "Mercedes-Benz". Në brendësi të tij u konstatuan dhe u sekuestruan 3 kallashnikovë dhe një fishek i paplatur. Në këtë mjet u gjetën gjurmët e Laert Haxhiut. Sipas hetuesve të çështjes, këqyrja e mëtejshme e automjetit për të përcaktuar numrin e

shasisë po vijon në Komisarriat e Policisë Lushnjë.

### HETIMET

Sipas burimeve nga policia, pas analizës së ngjarjes dhe informacioneve që ka mbledhur grupi hetimor, pjesë e të cilit ishin edhe drejtues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, rezultuan se ngjarja e djeshme ka lidhje me ngjarjen e datës 25.09.2016 ndodhur në qytetin e Lushnjës, ku është tentuar të vriten me armë zjarri 2 persona. Po të njëjtat burime thanë se përveç pistës së hakmarrjes, dyshohet se vrasja e dy ditëve më parë në qendër të qytetit të Lushnjës të ketë ndodhur për larje hespesh për trafik droge.



## Ja krimet e tmerrshme të bandës famëkeqe të Lushnjës



E dhe pse kanë kaluar 21 vite nga krijimi i Bandës së Lushnjës, përsëri hasmëritë në këtë qytet, vijojnë të jenë prezente. Kjo është dinamika e ekzekutimeve mes dy grupeve, ai i Aldo Bares dhe Artur Dajës. Banda kriminale famëkeqe e qytetit të Lushnjës, e cila kishte si kryetar të saj Alfred Shkurtin, i njohur ndryshe si Aldo Bare e kishte pikun e saj të gjatë viteve 1997 dhe 1998. Gjatë pretencës së Prokurorisë së Krimeve të Rënda, kundërshtari kryesor i Aldo Bares ishte Artur Daja dhe konflikti kishte nisur nga viti 1996. Vrasjet janë të shumta të realizuara nga "Banda e Lushnjës" si preja e kokës e deri tek ekzekutimi i kundërshtarëve me tritol dhe me breshëri automatiku. Një vit më vonë, në korrik '97-ës, në qytetin e Lushnjës u vra Ramadan Shkurti, vëllai i të pandehurit Alfred Shkurti. Aldo Bare, së bashku me viktimit dhe Enver e Bardhyl Rabija ishin nisur në drejtim të lokalit ku ndodhë Artur Daja. Gjatë shkëmbimit të zjarrit ka mbetur i vdekur shtetas Genci Kashari, i cili ishte në verandën e lokalit ku ndodhë edhe shënjestra Artur Daja. Aldo Bare së bashku me shokun e tij Enver Rabija, u larguan nga vendi i ngjarjes. Por të plagosur kishin mbetur në automjet Ramadan Shkurti dhe Bardhyl Rabija. Vetëm pak çaste më vonë, Daja edhe ky i plagosur u afrohet kundërshtarëve të tij dhe qëllon nga afër vëllain e Aldo Bares dhe mikun e tij të ngushtë Bardhyl Rabija. Pas vrasjes së vëllait të Aldo Bares, ky i fundit me qëllim hakmarrjen ndaj Artur Dajës, krijoi të ashtuquajturën "Bandë e Lushnjës". Sipas organit të akuzës, anëtarë ishin Ilir Stergu, Afrim Hoxha, Arben Boriçi, Enver Boriçi dhe Enver Dondolaku. Më 3 korrik të '97 në Lushnjë u vra shqiptaro-magedonasi Xhevat Demiri, i cili ishte miku i Dajës. 6 muaj më vonë, më 13 shkurt vritet Nimet Zeneli. Brenda muajit shkurt të '98 vriten në rrugën Kolonjë-Bitaj të Lushnjës, Masar Aliu dhe personi që ishte rastësisht me të Idajet Beqiri. Më 18 korrik të '98, në vendin e quajtur "Kodrat e ullinjeve" u vra me breshëri automatiku Luan Bilbili, i cili konsiderohej si shok i ngushtë i Artur Dajës. Më 21 tetor 1998 në fshatin Grabian të Lushnjës, pasi ia kishin djegur trupin më herët, Artur Dajës i presin kokën, duke e ekspozuar në të gjithë qytetin e Lushnjës (AbcNews).





Vendi ku ndodhi atentati

## Gjykata e dënoi Haxhiun në mungesë me 32 vite burg

### Atentati në shtator të 2016-ës, Xhulio Shkurti: Laert Haxhiu më tha: 'Nuk e ke të gjatë ti'

Laert Haxhiu është dënuar në mungesë me 32 vite burg për tentativën e vrasjes ndaj Xhulio Shkurti dhe Saimo Xheliu. Ngjarje kjo e ndodhur në shtator të 2016-ës në qytetin e Lushnjës. Mësohet se Shkurti gjatë marrjes në pyetje nga policia ka deklaruar: "Laert Haxhiu më tha: Nuk e ke të gjatë ti". "Nga deklaratimet e shtetasit Xhulio Shkurti rezultojnë se rreth orës 16:00, ai ka qenë duke ecur në këmbë në lagjen 'Çlirimi', në trotuarin e rrugës përpara furrës së bukës 'Zeneli', të shtetasit Din Zeneli së bashku me shokun e tij, shtetasin



Xhulio Shkurti

Saimo Xheliu. Në atë çast, përballë tyre në rrugë ka ndaluar një autoveturë e bardhë tip 'Smart', me targa italiane e drejtuar nga i pandehuri Laert Haxhiu. Ky i fundit kishte në dorë një pistoletë me të cilën ka qëlluar në drejtim të tyre, derisa i mbaruan fishekët e pistoletës. Një nga plumbat e pistoletës së të pandehurit ka qëlluar Xhulion në këmbën e majtë, ndërsa një tjetër ka goditur shtetasin Saimo Xheliu në pjesën e barkut. Pasi i kanë mbaruar fishekët e pistoletës, i pandehuri i ka thënë Xhulios: 'Nuk e ke të gjatë ti!'. Më pas e ka fyer dhe ka vazhduar rrugën me au-

toveturën e tij drejt kryqëzimit të gjimnazit '18 Tetori', citohet në dosjen në ngarkim të të pandehurit Laert Haxhiu. Për këtë ngjarje, Laert Haxhiu u dënua në total me 32 vjet burgim për veprat penale "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", embetur në tentativë; "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyeshe dhe i municionit"; "Prishja e qetësisë publike". Por, në ulje të 1/3 së dënimit, gjykata dënoi atë me 21 vjet e 8 muaj burgim. Haxhiu nuk bëri asnjë ditë burg, pasi prej një viti ai është në kërkim nga policia.


Jurgen Hoxha erdhi para një jave nga Holanda për dasmë, kushërira: Të të qaj ty apo motrën

# Viktimat panë autorët, Zamir Latifi: Çuna, na vranë!

I riu u qëllua me 35 plumba, vëllai: O do më vrasin dhe mua, o do t'i vras unë ata

#### LUSHNJE

Jurgen Hoxha dhe Zamir Latifi i kanë parë atentatorët, por nuk i mbijetuan dot sulmit me breshëri kallashnikovi. Dy të rinjtë ishin ulur në një tavolinë para lokalit bar-kafe, afër vendit të quajtur "Ura e Përroit" së bashku me 26-vjeçarën Marjus Xhepexhiu dhe Saimo Xhelilin, kur kanë parë automatjetin tip "Benz" (po vinte shëtitja e qytetit të Lushnjës), në të cilin ndodheshin kundërshtarët e tyre. Në çast, 23-vjeçari Zamir Latifi ka thirrur: "Çuna na vranë!". Kjo një thirrje e dëshpëruar, pasi masakra ka ndodhur shumë shpejt. Ndonëse të rinjtë janë ngritur menjëherë nga karriget dhe kanë tentuar të ikin duke dalë në rrugën kryesore, autorët i kanë vënë direkt në shënjestër: Zamir Latifi është bërë shoshë, pasi ka marrë në trup 35 plumba. Ndërsa shoku i tij 22-vjeçari, Jurgen Hoxha ka marrë 7 plumba në trup. Dy të rinjtë kanë dhënë shpirt në rrugë. Ndërsa, ka mbetur i plagosur me 2 plumba (një në krah e një në këmbë), Xhepexhiu, i cili aktualisht ndodhet në Spitalin e Traumës në Tiranë, jashtë rrezikut për jetën. Sulmit i ka mbijetuar i riu Sajmo Xhelili, i cili pohohet të ketë qenë në shënjestër të atentatit (në 25 shtator të vitit 2016, atij i është bërë një tjetër atentat) dhe kalimtari i rastit



Viktima Jurgen Hoxha

Bujar Turku, 66 vjeç. Ky i fundit ka marrë një plumb në këmbë. Fati ka qenë me Xhulio Shkurti, nipin e Aldo Bares (dhe ky shënjestër e atentatit të dy ditëve më parë), i cili vetëm 10 minuta para ngjarjes ishte larguar nga lokali ku po pinte kafe me miqtë e tij. Gjithçka ka ndodhur shumë shpejt, në sy të qytetarëve, të cilët kanë ikur nga sytë këmbët. I gjithë qyteti është përfshirë nga paniku. Një ditë pas ngjarjes me 2 të vranë e 2 të plagosur, mësohet se autorë të dyshuar të masakrës janë Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili. Burime të besueshme u shprehën se Laert Haxhiu ka dalë jashtë "Benz"-it dhe ka qëlluar me



Viktima Zamir Latifi

#### KUSHËRIRA E JURGEN HOXHËS

"O Shpirti motrës po ç'të them unë ty, ma helmova zemrën. Po si do ta shuaj unë mallin për ty! Nuk të kisha djalë halle, por vëlla të madh. Ti do bëhesh dhëndër o i bukuri im. Ne do vinim krushkë në dasmën e motrës sonë, javën që vjen. Kë të qaj unë o vëlla për ty, apo për motrën që ka dasmën pas një javë. Po si do të të tresë dheu ty o vëlla. Më dhemb shpirti o Geni", shkruan në kushërira e viktimës në 'FB'.

breshëri kallashnikovi. Nderkohë që Bilbili gjuante nga brenda makinës. Ngjarja e ndodhur pasditen e së mërkurës ka tronditur jo vetëm banorët e Lushnjës, por gjithë opinionin publik. Familjarët e viktimave janë shokuar, ndërsa kanë hapur dyert e mortit. Pasditen e djeshme i është dhënë lamtumira e fundit Jurgen Hoxhës, i cili një javë më parë kishte ardhur nga Holanda.

#### REAGIMI I FAMILJARËVE TË VIKTIMAVE

Kishte ardhur nga Holanda, pasi do të martonte vajzën e dajës, por ka gjetur vdekjen në "shtëpinë" e tij. Vetëm 22 vjeç, Jurgen Hoxha është larguar nga kjo jetë. Familjarët e të afërmit e të riut nuk gjejnë dot ngushëllim. Në një status në "Facebook", kushërira e parë e Hoxhës shkruan se nuk e beson dot atë që ndodhi. "O Shpirti motrës po

ç'të them unë ty, ma helmova zemrën. Po si do ta shuaj unë mallin për ty! Nuk të kisha djalë halle, por vëlla të madh. Ti do bëhesh dhëndër o i bukuri im. Ne do vinim krushkë në dasmën e motrës sonë, javën që vjen. Kë të qaj unë o vëlla për ty, apo për motrën që ka dasmën pas një javë. Po si do të të tresë dheu ty o vëlla. Më dhemb shpirti o Geni. Nuk mund ta besoj këtë që ndodhi... Motra jote

#### VELLAI I ZAMIR LATIFIT

"Ti ishe dhe je jeta ime shpirti i vëllait. Të dua më shumë se gjithçka. Këtë këngë e dëgjonim bashkë dhe do vazhdojmë ta dëgjojmë bashkë vëllai im", shkruan vëllai i Zamir Latifi në 'FB'. Pas këtij mesazhi prekës, miqtë i kanë shkruar atij në rrjetin social. Por, Mario duke iu përgjigjur atyre, shkruan në një koment: "O do më vrasin dhe mua, o do t'i vras unë ata që më vranë shpirtin tim, zemrën time".

nuk do të të harroj kurrë", shkruan S.J. Mesazhi rrëngëthës ka shkruar dhe vëllai i Zamir Latifit, i cili në "Facebook" mban emrin Mario Corana. "Shpirti im si kemi qeshur para tri ditësh dhe më the që kështu dua të të shoh gjithmonë të qeshur, por sot mi mbylle sytë me lot dhe kjo zemra ime nuk duron dot. Ti ishe dhe je jeta ime shpirti i vëllait. Të dua më shumë se gjithçka. Këtë këngë e dëgjonim bashkë dhe do vazhdojmë ta dëgjojmë bashkë vëllai im", shkruan Mario. Pas këtij mesazhi prekës, miqtë i kanë shkruar atij në rrjetin social. Por Mario duke iu përgjigjur atyre, shkruan në një koment: "O do më vrasin dhe mua, o do t'i vras unë ata që më vranë shpirtin tim, zemrën time".

**Polici i pikës së bllokimit: "Unë nuk pushë asgjë"**

**Vrasja e Çollakut, avokatët: Të ndryshohet trupi gjykses, qëndrim i njëanshëm në proces**

Në seancën e zhvilluar dje në Gjykatën e Krimeve të Rënda, ndaj të pandehurit Denis Shtraza, avokatët mbrojtës kërkuar ndryshimin e trupës gjyqësore. Kjo pasi avokatët akuzojnë gjyqtarët për qëndrime të njëanshme në procesin ndaj Shtrazës. Ndërkohë në seancën e djeshme dëshmoi edhe polici i pikës së bllokimit të mjeteve në Rrashbull. Ai deklaroi se nuk kishte gjetur njolla gjaku në gomën rezervë, ndryshe nga

**DESHMIA**

Në seancën e djeshme dëshmoi edhe polici i pikës së bllokimit të mjeteve në Rrashbull. "Oficerët panë diçka gjatë kontrollit dhe thanë makinën do e marrim mbrapsht, unë nuk pushë asgjë. Nuk mbajtëm as proces verbal", -rrëfeu polici.

çfarë kishin deklaruar oficeret Rehani Farruku, Alfred Hoxha dhe Lorenc Derishi në seancën e 9 tetorit. Më herët 3 oficerët pretenduan se njollat e gjakut që

mendohet se mund të jenë të viktimitës, janë gjetur kur mjeti që dyshohet të jetë rrëmbyer Çollaku, u çua në pikë bllokimi. Tre oficerët kanë deklaruar se atje u kon-

statua njolla e gjakut dhe mjeti u kthye për rishikim. "Oficerët panë diçka gjatë kontrollit dhe thanë makinën do e marrim mbrapsht, unë nuk pushë asgjë. Nuk mbajtëm as proces verbal", -rrëfeu polici i pikës së bllokimit të mjeteve. Për këtë arsye, mbrojtja kërkoi ballafaqim mes këtij të fundit dhe tre oficerëve të policisë. Kërkesë që u rrëzua nga gjykata. Gjithashtu, avokatët kërkuar të pyetet eksperti gjerman, për të përcaktuar vendndodhjen e



I pandehuri Denis Shtraza

makines ditën e ngjarjes, pasi prokurori u tërhoq nga kjo kërkesë. Por kjo gjë nuk u aprovua nga gjykata. Për këto arsye dhe duke pretenduar për njëanshmëri të gjykatës, avokatët kërkuar përjashtimin e trupit gjykses, të kryesuar

nga gjyqtari Ardit Mustafa. Ndërkohë, javën e ardhshme do të dëshmojnë në gjykatë ekspertët që kanë bërë analizën e ADN-së së gjurmëve të gjakut të gjetur në automjetin ku u ndalua Shtraza e Dalipaj. **in.all.**

**Tentoi të kalojë kufirin me pasaportë të falsifikuar, prokuroria: Të lihet në burg**

Klodiana Haxhij

**DURRËS**

Pak ditë pas arrestimit të shtetasit turk Muhammed Aydogmus, bashkë me familjen në port, pasi u kapën me pasaporta false, policia e Durrësit ka dhënë detajet lidhur me rastin. Pas hetimeve të kryera në bashkëpunim me Zyrën e Interpolit Tiranë, u evidentua se 39-vjeçari Muhammed Aydogmus ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar për organizatë terroriste nga Gjykata e Lartë kriminale turke. Specialistët për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Durrës bënë arrestimin e përkohshëm të tij, duke kryer të gjitha procedurat e duhura ligjore me qëllim ekstradimit drejt Turqisë.

**ARRESTIMI**

Muhammed Aydogmus 39 vjeç, banues në Turqi, u arrestua më datë 08.10.2017, ndërsa filloi procedimi penal në gjendje të lirë në ngarkim të bashkëshortes së tij. Kjo pasi së bashku me dy fëmijët e tyre kanë tentuar të kalojnë kufirin në Portin e Durrësit në drejtim të Italisë me pasaporta, të cilat dyshohet se ishin të falsifikuara. Mësohet se më datë 11.10.2017, pas njoftimit të marrë nga Interpol Tirana u



Muhammed Aydogmus

kryen procedurat mbi arrestimin e përkohshëm të tij, pasi kërkohej nga shteti turk për organizatë terroriste.

**VENDIMI GJYQËSOR**

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me datë 09.10.2017 mësohet të ketë shkuar kërkesa e

prokurorisë për vlefësim të ligjshëm të arrestimit dhe caktim masë sigurimi personal, atë të "Arrestit në burg" ndaj Muhammed Yasir Aydogmus. Gjithashtu, prokuroria kërkoi caktimin e masës së sigurisë "Ndalim dhe detyrim qëndrimi në një vend të caktuar" ndaj shtetas Nermin Aydogmus e dyshuar për veprën penale "Falsifikim i letërnjoftimeve të pasaportave ose i vizave" dhe "Kalim i paligjshëm i kufijve shtetërorë". Ndërkohë ndaj shtetasit turk, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vlerësoi të ligjshëm

arrestimin në flagrancë. Gjithashtu, vendosi masën e sigurisë "arrest në burg", për shkak të rrezikut të ikjes, por ai mund të qëndrojë në gjendje të lirë, duke paguar një garanci pasurore. Konkretisht i arrestuari Muhammed Yasir Aydogmus do të qëndrojë në gjendje paraburgimi deri në pagimin e garancisë pasurore në shumën prej 150.000 lekë, deri më datën 14.10.2017. Ndërkaq ndaj shtetas turke Nermin Aydogmus, u caktua masa e sigurisë "Detyrim për t'u paraqitur para policisë gjyqësore".

**Arrestohet në portin e Durrësit turku i kërkuar për terrorizëm**

*Gjykata: Të paguajë 150.000 lekë që të lirohet*

**SHKURT**

**Në pranga pronari i lokalit, rreh punonjësën dhe kundërshton policinë**

**FIER** - Policia e Fierit ka arrestuar në flagrancë pronarin e një lokalit, pasi ka dhunuar në rrugë punonjësën e tij. Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisarjatin e Policisë Fier arrestuan në flagrancë shtetasin Ervin Murati, 28 vjeç, banues në lagjen "11 Janari" Fier. Ky shtetas është kapur në flagrancë nga patrulla e policisë duke dhunuar (rrahur) në rrugë shtetasen N.Sh., 35 vjeçe, e punësuar në lokalin e tij në rrugën "Ramiz Aranitasi", Fier. Gjatë ndërhyrjes nga punonjësit e policisë për të parandaluar dhunën ndaj punonjësës së tij, shtetasi Ervin Murati i ka kundërshtuar me dhunë punonjësit e policisë duke i goditur ata. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprën penale "Kundërshtimi me dhunë i punonjësit të policisë së rendit publik".

**Hetimi ndaj gjykatësit, KLD: Arqile Basho liroi "trafikantrin"**

Këshilli i Lartë i Drejtësisë urdhëroi nisjen e hetimit disiplinor për gjykatësin e Vlorës Arqile Basho, i cili firmosi për lirimin e një të arrestuari për 5 tonë hashash në fshatin Llakutand. Në një njoftim për shtyp KLD theksoi se inspektorët kanë nisur verifikimin e rastit, pasi vendimi ka probleme serioze me ligjin. Mësohet se inspektorët do të kontrollojnë jo vetëm vendimet e shpallura, procesverbalet e seancave gjyqësore, por edhe për mënyrën sesi Arqile Basho u caktua për shqyrtimin e çështjes në fjalë. Kjo, pasi gjykatësi i mëparshëm kishte caktuar masën e "arrestit me burg" për të dyshuarin Rakip Arapaj, por më pas është zëvendësuar nga gjykatësi Basho që urdhëroi edhe lirimin e të 58-vjeçarit. Rakip Arapaj, i cili dyshohet si pronar i një sasive prej 5 tonë drogë që u gjet në shtëpinë e braktisur të vëllait të tij të ndjerë, u lirua me garanci pasurore prej 1 milion lekësh.

**STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON" me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA**

Dt 13.10.2017 ora 16:00 '  
Përfundon Ankand i Parë për pasuritë:

- Pasuria "Apratament" me sip. 27 m2, Nr. pasurie 7/83+1-3, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 166 me adresë L. Nr. 5 Kavajë Me çmim 7 840 EURO
- Pasuria "Apratament" me sip. 40 m2, Nr. pasurie 7/83+1-3/1, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 167 me adresë L. Nr. 5 Kavajë Me çmim 11 600 EURO
- Pasuria "Apratament" me sip. 66 m2, Nr. pasurie 7/83+1-4, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 168 me adresë L. Nr. 5 Kavajë Me çmim 18 960 EURO

Ankand i Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria), Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

Ne date 16.10.2017 ne oren 16.00 ne zyrën e permbaruesit gjyqesor privat **Irisa Tereziju PF** me adrese ne "Rruga Fadli Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankand per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit Aree-Truall+Shtepi Banimi me siperfaqe totale 2000 m<sup>2</sup> nga e cila truall 500 m<sup>2</sup> nga kjo ndertese 3 kateshe me siperfaqe totale 544 m<sup>2</sup>, e regjistruar ne regjistrin hipotekor me volum 4, faqe 3, numer pasurie 34/44, ne zonen kadastrale 1934, me adrese Hasan (Kruje).Cmimi ne ankand te trete eshte ne vleren 6,552.000 (gjashte milion e peseqind e pesedhjetë e dy mije) lekë.





### INVITATION TO TENDER

#### REHABILITATION of Health Center in Fier

The Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by HAP Centre. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate the Health Center in Patos, in the Municipality of Fier. In the context of this initiative, HAP Centre is requesting offers from companies interested in carry out those rehabilitation works. The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link

<https://drive.google.com/drive/folders/0B4R3lo0APolbSVNURJF5aGZldUU>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by **sending an email to info@hap.org.al until 16<sup>th</sup> October 2017.**

The interested Companies must participate in the site visit to take place within **October 2017**. The details of **place and time of the visit will be given to the interested Companies on the 17<sup>th</sup> October 2017.**

The bidding Companies should submit their offers to **HAP Centre no later than end of business day on the 10<sup>th</sup> November 2017.**

The offer should include:

1. Letter of interest;
2. The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Annex 2);
3. The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Annex 2);
4. CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
5. CVs of directors of the Company;
6. CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Annex 4.2 and Annex 4.3);
7. The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Annex 4, Annex 4.1.1 and Annex 4.1.2);
8. Copy of the registration and license of the company;
9. Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
10. Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works);
11. For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope **no later than end of business day on the 10<sup>th</sup> November 2017** to the address:

Subject: **REHABILITATION OF HEALTH CENTRE OF PATOS IN FIER REGION**

Procurement Team

HAP Centre

Rruga "Themistokli Germeji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania

E-mail: [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al); Website: [www.hap.org.al](http://www.hap.org.al)



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



### INVITATION TO TENDER

#### REHABILITATION OF Health Center in Roskovec

The Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by HAP Centre. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate 3 Health Centers in Kurjan, Strum and Roskovec in the Municipality of Roskovec, in Fier Region. In the context of this initiative HAP Centre is requesting offers from companies interested in carry out those rehabilitation works.

The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link

<https://drive.google.com/open?id=0B4R3lo0APolbEc2T0tuS1RqVm8>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by **sending an email to info@hap.org.al until 16<sup>th</sup> October 2017.**

The interested Companies must participate in the site visit to take place within **October 2017**. The details of **place and time of the visit will be given to the interested Companies on the 17<sup>th</sup> October 2017.**

The bidding Companies should submit their offers to **HAP Centre no later than end of business day on the 10<sup>th</sup> November 2017.**

The offer should include:

1. Letter of interest;
2. The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Annex 2);
3. The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Annex 2);
4. CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
5. CVs of directors of the Company;
6. CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Annex 4.2 and Annex 4.3);
7. The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Annex 4, Annex 4.1.1 and Annex 4.1.2);
8. Copy of the registration and license of the company;
9. Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
10. Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works);
11. For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope **no later than end of business day on the 10<sup>th</sup> November 2017** to the address:

Subject: **REHABILITATION OF HEALTH CENTRE OF KURJAN, STRUME, ROSKOVEC IN FIER REGION**

Procurement Team

HAP Centre

Rruga "Themistokli Germeji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania

E-mail: [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al); Website: [www.hap.org.al](http://www.hap.org.al)



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



### Call for: Engineering Company to provide supervisory works for the rehabilitation of four Health Centres in Fier region

Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by Health for All Centre in Fier and Diber Regions. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

To improve conditions for health workers and users in four Health Centres in Fier, HAP Centre will contract an engineering company, here in called **The Contractor**, to do the rehabilitation in those Centres. To supervise the **Contractor's** works, HAP Centre will contract an engineer Company, here in called **The Provider**, to supervise the rehabilitation works as described in the TOR in the below link:

<https://drive.google.com/file/d/0B4R3lo0APolbNGIQRmVfN0t6Tms/view>

The offer should include:

1. A financial offer specifying only the supervisor-day fee and transportation cost;
2. CV of the bidder, CV of the Directors of the Company and its technical team, with details of their field of engineering, and detailed description of previous works similar to the ones expected under this TOR;
3. Names of three references of similar works, from which HAP can get information on the qualification of the bidder;
4. Licenses and registrations proving that the bidder is duly accredited and certified for carrying out the works described in the TOR

Those submitting an application should be aware that, if selected and contracted, they will be required to issue invoices (VAT or A4).

**Deadline for application**

The offers must be delivered by **25 October 2017** in sealed envelopes and with clearly marked "Public Invitation to Tender for Engineering Company" to;

Procurement Team

HAP Centre

Rruga "Themistokli Germeji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania

E-mail: [info@hap.org.al](mailto:info@hap.org.al); [www.hap.org.al](http://www.hap.org.al)

\*Please note that the shortlisted applications will be contacted within **08 November 2017.**

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra



Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

## BalkanWebJ.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ  
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET  
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR  
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



Balkan Barometër: Vendi ynë nuk arrin të paguajë faturat

# Sondazhi, 30% e shqiptarëve nuk blejnë dot ushqime


## Indeksi i urisë: Shqipëria e fundit në Europë

Voltiza Duro

Rreth 30% e shqiptarëve nuk janë në gjendje të përballojnë blerjen e ushqimeve, veshjeve apo elementëve të tjerë bazë për të jetuar. Ky fakt është bërë i ditur nga sondazhi i fundit i opinionit të kryer nga Balkan Barometer, lidhur me standardet e jetesës dhe masën në të cilën njerëzit janë në gjendje të përballojnë nevojat e tyre të përditshme. Në raport, theksohet gjithashtu, se 43% e familjeve shqiptare nuk janë në gjendje të sigurojnë ngrohje për shtëpitë e tyre, ndërsa 30% e tyre nuk mund të paguajnë kreditë e tyre hipotekore. Rreth 1000 shqiptarë mbi 18 vjeç i janë përgjigjur anketimit me 100 pyetje ku 86% e tyre janë përgjigjur se dallimet mes të pasurve dhe të varfërve janë vazhdimisht në rritje në vendin tonë. Nga ana tjetër, sipas sondazhit të opinionit, Shqipëria gjithashtu ka përqindjen më të lartë të njerëzve që pretendojnë se nuk janë në gjendje të përballojnë të paktën një javë pushime jashtë vendit, shifër kjo që arrin deri në 70%. Ajo që del jashtë është fakti se Bosnja dhe Kosova, GDP, e të cilëve për kokë banori janë të ngjashme me Shqipërinë, nuk ofrojnë përgjigje të tilla negative



Foto ilustruese



### INDEKSI I URISË

Një tjetër raport ndërkombëtar e rendit vendin tonë pranë vendeve të botës së tretë, për sa i përket nivelit të urisë. Instituti Ndërkombëtar i Politikave dhe

### SONDAZHI

Në raport, theksohet gjithashtu, se 43% e familjeve shqiptare nuk janë në gjendje të sigurojnë ngrohje për shtëpitë e tyre, ndërsa 30% e tyre nuk mund të paguajnë kreditë e tyre hipotekore.

Kërkimit Ushqimor ka publikuar "Indeksin e Urisë 2017" në të cilin Shqipëria renditet e 48-ta në botë dhe e fundit në rang europian. Madje paraqitet si vendi që e vuan urinë më tepër se çdo vend tjetër i rajonit, pasi vjen pas Maqedonisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi apo Serbisë. Ky raport ka marrë në shqyrtim 119 vende, e pavarësisht renditjes, vendi ynë rezultoi të ketë bërë përmirësim të dukshëm në krahasim me vitin 2008. Me një indeksim ku norma më e lartë tregon performancë më të dobët, Shqipëria në vitin 2017 grumbullon 11.1 pikë nga 11.8 pikë që grumbullonte në vitin 2016. Por edhe pse ka përmirësim, vendi ynë ngellet më problematiku në Europë, i etiketuar si një vend që vuan nga uria.



### Bashkia e Tiranës, ftesë qytetarëve

Të dielën zhvillohet 'Maratona e Tiranës' për 2500 vrapues nga 40 shtete

Këtë të dielë do të zhvillohet Maratona e Tiranës, ku do të marrin pjesë rreth 2500 vrapues nga 40 shtete të ndryshme të botës. Ky eveniment rikthehet në edicionin e saj të dytë dhe do të paraqitet me itinerarin e certifikuar nga "Association of International Marathon and Distance Race" dhe si pjesë e shtëpisë botërore të atletikës "International Association of Athletics Federation". Itinerari i ri do të përkohet pikat më kryesore të qytetit, duke e kthyer këtë garë jo vetëm në sfidë për garuesit, por edhe do t'u dhurojë qytetarëve të Tiranës një shfaqje ndryshe, e cila promovon të jetuarit shëndetshëm nëpërmjet sportit. Kategoritë pjesëmarrëse në këtë garë do të jenë: 'Fun Run', 'We too', 'Half Marathon' dhe 'Tirana 10K'. Pjesë e kategorisë 'Fun Run' do të jenë nxënësit e shkollave të Tiranës, të cilët do të vrapojnë në rrugët e qytetit duke mbartur një mesazh sensibilizues "edukimin e brezave nëpërmjet sportit". Kategoria 'We Too' do të mirëpresë të gjithë individët me aftësi ndryshe, duke i parë si shembull motivimi. Ndërsa, 'Half Marathon' (21, 0975 km) dhe 'Tirana 10K' (10 km), do të jetë e hapur për të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeç, shqiptarë dhe të huaj, profesionistë dhe amatorë. Për ta kthyer këtë garë sportive në një ditë feste, Bashkia e Tiranës fton gjithë qytetarët e Tiranës që nuk garojnë, të dalin në datë 15 tetor dhe të mbështesin sportistët pjesëmarrës. Midis vrapuesve do të marrin pjesë edhe disa personazhe të njohur dhe kanë për të përshkruar një sasi të përcaktuar kilometrash.

### KRUJA NE PAZARIN E RI

Pazari i Ri mirëpritri dhjetëra artizanë nga qyteti historik i Krujës, të cilët ekspozuan produktet e tyre në hapësirën më të veçantë të kryeqytetit. Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe të Krujës, organizoi eventin njëditor "Mozaik Kruje" dhe "Artisans Fashion Night" për promovimin e bizneseve dhe vlerave të zonës ku operojnë, si dhe rrijtëzimin social ekonomik të zonës. Kryebashkiaku Erion Velaj theksoi se Pazar i Ri është kthyer tashmë në gurin e kurorës së gjithë investimeve që kanë ndodhur në kryeqytet. Ai shpreh vullnetin e Bashkisë së Tiranës për të bashkëpunuar për projekte të tjera në të ardhmen.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
 SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje dhe implementim pajisje sigurie "Advanced Network Security Threat Prevention", për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 5,000,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hali", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
 BIC: STANALTR  
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje dhe implementim pajisje sigurie "Advanced Network Security Threat Prevention", për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **7 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**United Nations Development Programme**

**VACANCY ANNOUNCEMENT**

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.  
**Job ID:** 12394

**Post Title:** Programme Associate  
**Duty station:** Tirana, Albania  
**Duration of Assignment:** 1 year with possibility of extension  
**Service Contract (SC)**  
**University degree (Bachelor's level)** in social sciences, law, economics, public policy or development related discipline  
**2 years** of relevant administrative or programme experience is required; Demonstrated experience and ability in building and maintaining partnerships and working relationships with civil society and other stakeholders, including government and local government officials, civic leaders, media, business people and international donors is required; Demonstrated capacity to undertake assigned responsibilities and work under pressure; Experience with advocacy on rights, especially on R/E and disability rights issues at the national level, including high-level events, an asset; Familiarity with donor priorities on social inclusion, including disability issues and experience with developing partnership offers, an asset; Experience in working with persons with disability, familiarity with the key issues confronting persons with disabilities, an asset; Communication and report-writing skills in English;  
**Full working knowledge of English and Albanian is essential**  
**17/10/2017**  
 Available at UNDP site:  
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>  
 Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/>). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.



"Kjo kategori merr nga shteti vetëm 100 mijë lekë, ja pengesat dhe paragjykimet që hasim"

Voltiza Duro

Rreth 300 fëmijë në vendin tonë janë të prekur nga sindroma Down, çka nuk i jep mundësinë që të ndihet të barabartë në shoqërinë ku jetojnë, për shkak të nevojave të veçanta që ata kanë. Emanuela Zaimi, nëna e një prej vogëlushëve të diagnostikuar me këtë sindromë, njëkohësisht dhe themeluese e fondacionit "Down Syndrome Albania" rrëfen për "Gazeta Shqiptare" të gjitha pengesat që duhet të kalojnë këta fëmijë për t'u pranuar e për t'u ndier pjesë e komunitetit. Ajo thekson se numri i mësuesve të specializuar për trajtimin e kësaj kategorie është tejet i vogël, kundrejt numrit të nxënësve të prekur nga kjo sindromë. Drejtoresha Zaimi tregon e shteti shqiptar ende nuk është në gjendje të ofrojë shërbimet e duhura për kategorinë e fëmijëve me nevoja të veçanta.

**Sa është numri i personave me sindromën Down në Shqipëri?**

Sipas shifrave të marsit 2017, numri i personave me sindromën Down, që jetojnë në Shqipëri është 656. Kjo shifër ka të identifikuar vetëm individët që janë pjesë e skemës së vlerësimit nga KM-CAP dhe që marrin pagesën e aftësisë së kufizuara që iu takon sipas ligjit. Rreth 300 fëmijë të moshës 0-16 vjeç janë të prekur nga sindroma Down.

**Çfarë trajtimi ofron organizata juaj për të prekurit nga kjo sindromë?**

Shërbimet që marrin fëmijët 0 deri në 11 vjeç, janë terapi individuale, por edhe terapi fizike, terapi zhvillimi, terapi gjuhë dhe të të folurit, si dhe terapi ABA. Të gjitha këto terapi deri më tani janë ofruar pa pagesë për prindërit, falë fondeve të biznesit privat në vend, fondeve nga donatorë projektsh, aktiviteteve dhe fushatave për ngritje fondesh, si dhe donacioneve të qytetarëve.

**Po nga shteti a marrin mbështetje të mjaftueshme?**

Gjithçka merr një fëmijë apo individ me sindromën Down nga shteti shqiptar është vetëm 10,000 lekë të reja në muaj. Me ligjin aktual, personave me këtë sindromë nuk u takon pagesa për kujdes-

## 300 fëmijë të prekur nga sindroma Down

### Zaimi: 50% prej tyre nuk shkojnë në shkollë



Emanuela Zaimi drejtoresha e fondacionit DSA

**223**

**MËSUES NDIHMËS**

"Nga të dhënat e MAS, numri i mësuesve ndihmës në Shqipëri për vitin shkollor 2016-2017 ishte 223, ndërsa numri i nxënësve me aftësi të kufizuara ishte 3252.

**50%**

**NUK SHKOLLOHEN**

Treguesit e studimit janë alarmante, pasi 50% e fëmijëve me këtë sindromë në moshë shkollare nuk janë në bankat e shkollës, të paktën jo në ato të shkollave shtetërore.

shme, me qellim prindërimin. Idealisht ne dëshirojmë që të kalojmë në modelin e Programit të Ndërhyrjes së Hermshe, që do të thotë, të asistojmë zhvillimin e fëmijës në ambient natyral, bazuar edhe në prioritet e prindërve krahas nevojave specifike të fëmijës për ndërhyrje terapeutike.

**Sa pranohen këta fëmijë nga shoqëria jonë dhe a ka rastet kur paragjykojnë?**

Në përgjithësi vërtet kemi një shoqëri të paditur mbi fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, por nga ana tjetër, shoqëria mundohet të krijojë empati në të tilla raste. Unë mendoj që qasja e duhur institucionale ndaj fëmijëve tanë, me kohën do të japë efektet e saj edhe në eliminimin e paragjykimet nga shoqëria.

**Na tregoni një rast kur fëmija është ndier i papranuar në shoqëri.**

Fëmija ndihet i përjashtuar nga shoqëria kur luan i vetëm në grupin e kopshtit apo shkollës, kur organizohen festa dhe fëmijës nuk i jepet asnjë rol pjesëmarrës ose kur prindërit e fëmijëve me zhvillim tipik, ruajnë fëmijën e tyre për të mos u afruar me fëmijën me aftësi të kufizuara.

**Cilat janë sfidat me të cilat përballlet organizata juaj?**

Shteti shqiptar nuk ofron mbështetje për shërbimet tona, duke na lënë të përballim me sfida të mëdha financiare. Kur ofron një shërbim pa pagesë, është e vështirë të sigurosh qëndruesmëri financiare. Ne aktualisht kemi fonde deri në mars 2018. Nuk e dimë çdo të ndodhë më pas, nëse nuk gjejmë dot donatorë mujorë. Shoqata DSA ka nevojë për 6000 euro fond mujor, për të ofruar shërbim për 38 fëmijët e qendrës. Donatorët që ne kemi mbulojnë vetëm 2600 euro, të cilat shkojnë pothuajse të gjitha për shtetin.

### Aktivite sensibilizuese gjatë muajit tetor

## Fondacioni "Down Syndrome Albania", në ndihmë të të prekurve që prej 2014-ës

Qendra e Arritjes dhe Zhvillimit si pjesë e Fondacionit "Down Syndrome Albania" hapi dyert në shërbim të fëmijëve apo individëve me këtë sindromë në qershor të vitit 2014. Misioni i këtij fondacioni është të përkushtohet në promovimin dhe përkrahjen e së drejtës legjitime të pranimit, përfshirjes dhe integritimit të individëve me sindromën Down në shoqërinë shqiptare, bazuar në Konventën e të Drejtave

të Njeriut dhe Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara. Në kuadër të muajit tetor, si muaj ndërgjegjësimi për sindromën Down, DSA zhvillon aktivitete të shumta sensibilizuese. Gjithashtu, kjo organizatë asiston me prindërit sa herë hasin pengesa në procedurë me shtetin, si në procedurat e KMCAE, regjistrimit në çerdhe, kopshte dhe shkollat, ndërhyrje në rastet e diskriminimit etj.

tarinë. Shteti ende nuk është në gjendje që të ofrojë shërbimet e duhura për çdo moshë të individit me sindromën Down.

**Sa fëmijë me sindromën Down shkojnë në shkollë?**

Treguesit e studimit që ne bëmë këtë vit janë alarmante, pasi 50% e fëmijëve me këtë sindromë në moshë shkollare, nuk janë në bankat e shkollës, të paktën jo në ato të shkollave shtetërore. Sipas të dhënave zyrtare të siguruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për vitin shkollor 2016-2017, individë me sindromën Down në moshë shkollare nga 3-18 vjeç, që

frekutojnë institucionet arsimore publike ishin 114. Nga 114 individë me sindromën Down, në moshë shkollare, rezultoi që 27 prej tyre ndiqnin kopshtin, 68 arsimin fillor, 18 në arsimin e mesëm të ulët dhe 1 në arsimin e mesëm të lartë.

**A arrijnë të adaptohen këta fëmijë në shkollë?**

Nëse fëmija mbështetet me shërbimet e nevojshme dhe cilësore terapeutike që në fëmijërinë e hershme, i jepet mundësia për të zhvilluar potencialin e tij maksimal. Është totalisht e mundur që një fëmijë me sindromën Down të shkojë në

çerdhet, kopshtet e shkollat e përgjithshme, si çdo moshatar tjetër.

**Sa është numri i mësuesve të specializuar për trajtimin e nxënësve me sindromën Down në shkollat publike në vend?**

Nga të dhënat e MAS, numri i mësuesve ndihmës në Shqipëri për vitin shkollor 2016-2017 ishte 223, ndërsa numri i nxënësve me aftësi të kufizuara ishte 3252. Pra, jemi në nivele qesharake! Absurditeti i shtohet dhe fakti që shumë prej këtyre mësuesve rezultojnë të paafte për të asistuar fëmijët me aftësi të kufizuara.

**Në rastet kur në shkollat nuk ka mësues të specializuar, si veprohet?**

Kur shkollat nuk ka mësues ndodhin 3 skenarë: fëmija rri vetëm, nëse nuk ka sjellje shqetësuese për klasën dhe zhvillimi i tij është i mirë; në klasë me fëmijën rri nëna e tij ose prindërit paguajnë privatisht mësues ndihmës.

**Cilat janë vështirësitë që hasin prindërit e një fëmije me sindromën Down?**

Shumë! Në çdo etapë të bashkëjetesës, pasi nuk ka asnjë shërbim dhe përkrahje nga shteti përtej atij 10,000-lëkshi. Familja duhet të sigurojë çdo gjë vete. Vështirësitë më të mëdha i kanë prindërit e individëve me sindromën Down mbi 16-18 vjeç, kohë kur individit hyn në një etapë totalisht izoluese dhe përjashtuese, pasi nuk i ofrohen mundësitë e duhura për të arritur pavarësinë sociale, për të bërë një jetë aktive dhe gjithëpërfshirëse në komunitet.

**A ofrohet një terapi për prindërit lidhur me mënyrën se si duhet të trajtojnë fëmijën e tyre me sindromën Down?**

Ne aktualisht në qendër ofrojmë terapi individuale për fëmijët me SD. Herë pas here, ne bëjmë dhe takime me të gjithë prindërit për të diskutuar tema të caktuara, apo organizojmë trajnime të ndry-

## HISTORIA E AKTORIT LETER E HAPUR


Vajza e aktorit të madh Viktor Gjoka: Ime më ishte asistentja e tij dhe kontribuoi në rritjen artistike

# Floreta Gjoka: S'kam qenë kurrë shoqja e gruas së babait tim

*"Kam 50 vjet që e vuaj këtë mashtrim. Unë kam norma të larta morale"*

FLORETA GJOKA

Unë jam Floreta Gjoka, një nga vajzat e regjisorit dhe aktorit Viktor Gjoka, historia personale e të cilit përveç se na vrau para 50 vitesh, po na rivret sërish sa herë që në gazetë botohen artikuj mbi jetën e tij private. Unë kam qenë vajzë e rritur kur babai im vendosi të linte nënën dhe katër fëmijë që ishin ne, për të nisur një histori të re. Se si nisi, ne as nuk kemi dashur të futemi në të thella e të merremi me të, pasi unë kisha një nënë fisnike që na brumosi dhe ne fëmijëve të tillë e plot dinjitet. Nëna ime, veç bukurisë e mirësisë, kujdesej për tim atë duke qenë asistentja e tij personale, duke pasur merita të veçanta në karrierën e babait tim. Ato e dominon dhe e respektonin njëri-tjetrin aq kohë sa ishin bashkë me çdo kënaqësi e problem si gjithë familjet që jetuan në ato kohëra. Në çdo shkrim të deritanishëm pasi lartësohet figura e babait tim, tregohet dhe historia e tij me gruan e dytë Helenën, që ishte më e re në moshë se ai e që sipas thashethemeve unë e kam pasur shoqe. Ky fakt krejtësisht i rremë, i pavërtetë ka tronditur mua



Floreta Gjoka

dhe familjen time për vite me radhë dhe na ka dëmtuar psikologjikisht shumë, sidomos mua e time më, e cila padyshim që nuk besonte në andralla të tilla. Sot, unë Floreta Gjoka pensioniste rrëfej siç kam treguar gjithmonë se unë s'kam pasur asnjë lidhje me Helenën. Ajo s'ka qenë kurrë pjesë e jetës sime. Unë kam norma të larta morale. Ndaj, ju lutem, ju shkronjëseve të artikujve mbi babain tim, më lini rehat, boll kemi vua-



Viktor Gjoka



Viktor Gjoka me familjen e tij



Floreta Gjoka me nënën e saj

jtur dramën e ndarjes së babait nga familja jonë. Nuk paragjykoj askënd që mund ta bëjë veprimin e mësipërm, pra të ketë shoqëri me gruan apo burrin e prindit respektiv, por unë nuk e kam bërë, thjesht sepse kjo jam unë, e ky është morali im. Mesa kuptoj nga gjithë kjo gënjeshtëri mbi mua, duket se njerëz të caktuar duan të përligjin veprimet e tyre duke më përfshirë mua në histori si gjoja mikështa, por kjo është një maskaradë, fyerje për mua e familjen time. Tani që jam në këtë moshë kuptoj se indirekt këta persona na e kanë nxirë jetën duke ushtruar presion psikologjik prapa shpine deri në persekutim. Si të rinj e të pafajshëm që ishim, atë here nuk e dimin shkakun pse krijoheshin shqetësime nga më të ndryshmet. Jeta jonë private ishte e pavarur nga ky problem a histori e ndodhur më parë. Problemi ynë ishte se na mungonte një prind. Të gjithë këtë barrë, të fjalëve, thashethemeve, e kam mbajtur unë padrejtësisht dhe sot që kanë kaluar 50 vjet, kjo histori rikthehet sërish e pandryshuar, pa etikën që dikush lëndohet. Mjaft më! Unë s'kam qenë kurrë shoqja e gruas së dytë të babait tim.

### Vuante prej vitesh nga një sëmundje e rëndë

## Shuhet në moshën 49-vjeçare ish-ministri Dritan Prifti

Ndërron jetë në moshën 49-vjeçare ish-ministri i Ekonomisë, Dritan Prifti. Ai vuante nga 'Leucemia akute', sëmundje të cilën e deklaroi para zgjedhjeve të qershorit 2017, pasi nuk mori pjesë në garën për deputet. Rreth 10 vjet më parë, në moshë fare të re, ai përballoi një tjetër sëmundje të rëndë, por që në atë kohë e hodhi pas krahëve. Dritan Prifti lindi më 27 gusht 1968 në Berat. Në këtë qytet ai mori edhe arsimimin fillestar. Më pas Prifti do të transferohej me studime në një prej universiteteve më të njohura në

botë, siç është ai i Harvardit. Dritan Prifti do të ishte nga të paktët studentë shqiptarë që do të rikthehej në Shqipëri në vitin e "mbrapshtë" '97. Vetëm 3 vite më vonë ai do të angazhohej në politikë, ku do të dallohej në radhët e Partisë Socialiste. Në periudhën e viteve 2001-2002, ai ishte drejtor i përgjithshëm i njëriës prej korporatave më të rëndësishme në vend, siç ishte KESH. Në rolin e drejtorit të KESH, ai u dallua për aftësi të larta menaxheriale, të cilat më pas do ta katapultonin në mesin e figurave më të spikatura të Partisë Socialiste. Më shumë ai do të afirmohej në vitin 2005, ku u bashkua me Ilir Metën në

Lëvizjen Socialiste për Integrim dhe do të rreshtohet kundër Nanos. Me krijimin e LSI-së, për 6 vite me radhë Dritan Prifti do të ishte një nga figurat më të larta të kësaj force politike. Për gati 2 vite me radhë ai do të mbante postin e ministrit të Energjetikës. Fill pas largimit të Metës dhe themelimit prej tij të LSI-së, Dritan Prifti ishte një ndër krerët e kësaj force. Ai do vihej në epiqendër të zhvillimeve politike pas 28 qer-



Dritan Prifti

shorit, ditës së zgjedhjeve në 2009, ku u bë "kumbar" i një aleance mes Berishës e Metës për të qeverisur bashkë për 4 vjet. Në vitin 2011 Dritan Prifti do të largohej nga Ministria e Energjetikës pas një skandalit të përgjimit të videos me Ilir Metën, ku edhe iu desh të paraqitej në prokurori. Pas vitit 2013 Dritan Prifti do të largohej nga politika aktive, pasojë edhe e sëmundjes së rëndë nga e cila ai vuante.

DEBATI

# BUTRINTI

## Forumi i Trashëgimisë 'rrëzon' Kumbaron: Është gërmuar 30 cm, betoni është ndërtim

**F**orumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë ka analizuar e kundërshtuar mbrojtjen që ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro i bëri projektit të pikës së shërbimit-kafene në Butrint. Përmes një postimi në "Facebook", Forumi argumenton se pse ai ndërtim dëmton sitin, jo vetëm duke gërmuar nëntokën, por edhe duke e dyfishuar hapësirën e përdorur nga 64 metra në 157 metra katrorë.

### REAGIMI I PLOTË

Pas pesë orësh diskutime në komisionin parlamentar, ku ministrja Kumbaro u vendos nën kritika edhe nga vetë deputetët socialistë për skandalin e ndërtimit në Butrintin, duhet theksuar edhe njëherë se ky ndërtim nuk është i paligjshëm. Nëse do të ishte i tillë, do të akuzonim të gjithë sot firmën private. Ndërtimi në Butrint është ligjshëm, licencuar dhe ka mbrojtjen e plotë të Ministrisë së Kulturës, e cila ka përgatitur ligjin, udhëzimet dhe është vetëfirmosëse e të gjitha lejeve të dhëna. Për këtë qëllim, Forumi dhe të gjithë zërat publikë po kritikojnë Kumbaron dhe konceptin e saj për zhvillimin e parkut të Butrintit.

Më poshtë disa pika në vijim të seancës së djeshme dhe dokumenteve të publikuara:

1. Ministrja pranoi se nuk ka përgatitur planin e menaxhimit të parkut të Butrintit, sepse, sipas saj, nuk ka pasur kohë. Që këtu zbulohet nxitimi i saj për të dhënë një leje për biznes privat, me afat disave javë, ndërkohë që në planin e menaxhimit mund të propozohet një zgjidhje tjetër. Kjo i ngjan lejeve abuzive për ndërtime që dhanë për 20 vjet kryetarët e bashkive, pa pasur një plan rregullues të qyteteve. Krahurën urbanistike e vuajmë të gjithë sot.

2. Ndërtimi i ri që po ngrihet rreth 50 larg teatrit antik (apo amfiteatrit, siç e quan Kumbaro) është një bar-kafë private. Këtë e



Projekti dhe punimet në Parkun Kombëtar të Butrint



provon edhe projekti i IMK i publikuar dje nga vetë stafi i Kumbaros "Coffee bar service point". Ministrja nuk iu përgjigj argumentit të arkeologëve se përse kjo kafë nuk ndërtohet jashtë zonës arkeologjike, ku mund të evitohen dëmtimet ndaj sitit.

3. Ligji i trashëgimisë, në nenin 30, pika 3 thekson se "Ne zonat arkeologjike "A" është" e ndaluar çdo lloj ndërhyrjeje me karakter ndërtimor". Justifikimi i ministrisë është se nuk po ndërtohet objekti i ri, por vetëm rehabilitohet ndërtesa ekzistuese e vjetër. Dokumentet e oficerit të policisë gjyqësore që ka bllokuar punimet më datë 2 tetor, dëshmojnë se objekti ekzistues (shtëpia e arkeologëve) ka një sipërfaqe prej 64 metra katrorë, ndërkohë që dy shtesat e reja zënë rreth 157 metra katrorë të parkut. Pra, "rehabilitimi" zë dy herë më shumë truall se vetë ndërtesa ekzistuese.

4. U justifikua që ndërtimi i ri nuk prek nëntokën dhe bëhet fjalë për "beton të varfëruar". Projekti i IMK vërteton atë që shikojmë të gjithë me sy, është gërmuar një themel me beton prej 30 cm dhe është vendosur, gjithashtu, një shtresë hekur. Ministres i duhet shpjeguar që çdo objekt që ka beton dhe hekur quhet ndërtim, pa

### Gjashtë pikat që kundërshtojnë mbrojtjen e ministres për ndërtimin në zonë arkeologjike A



Ministrja e Kulturës, Mirela Kumbaro

varësisht prapashtesës "i përkohshëm". Më poshtë edhe përkufizimi i ndërtimit në ligjin Nr. 107/2014, Për Planifikimin dhe zhvillimin e Territorit: "Ndërtim" është çdo objekt që ndërtohet ose instalohet në territor, me vendosje të

palëvizshme apo të përkohshme, dhe që zhvillohet nën dhe/ose mbi tokë."

5. Justifikimi se ndërtimi i kafes private nuk prek murin antik është një gënjeshtër tjetër. Vetë leja e dhënë nga Ministria e Kulturës dhe IMK e titullojnë punimin: "Rehabilitimi dhe ndërtimi i pikave të shërbimit të muri antik". Projekti dëshmon se ndërtimi i ri modern me bazament betoni po prek murin antik në pjesën anësore të godinës ekzistuese të arkeologëve. Edhe fakti i Kumbaros që kjo godinë e ka mbuluar murin antik nga syri i vizitorëve gjatë 70 viteve të fundit, sepse është ndërtuar në periudhën e diktaturës, nuk e zhbën përgjegjësinë e saj për të mbuluar edhe atë pak pjesë që ka mbetur nga muri. Me këtë logjikë, ministri i radhës i Kulturës, do të shtojë sipërfaqen e kafeve dhe restoranteve në park, sepse e para që e bëri këtë ishte Mirela Kumbaro.

6. Për sa i përket akuzës për pengimin e gazetarëve që të hyjnë në ambientet e Butrintit, Kumbaro përdori si justifikim Nenin 16, pika

2 të ligjit të Trashëgimisë, i cili thekson: "Fotografimi, filmimi ose regjistrimi kompjuterik dhe publikimi i objekteve të trashëgimisë kulturore, të ekspozuara në muzetë vendore, bëhet pasi të jetë marrë autorizim nga institucioni shtetëror, në varësi të të cilit është muzeu. Për objekte të tilla, të ekspozuara në muzetë kombëtare, leja miratohet nga ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve."

Pra, leja me sms që jep Kumbaro për BBC apo mediat e tjera, është vetëm për objektet që mund të filmohen në muzetë kombëtare dhe nuk kufizon filmimin e parkut në tërësi. Edhe ky kufizim ka për qëllim evitimin e falsifikimit të objekteve të trashëgimisë apo dëmtimit të tyre nga blicet. Aktualisht, çdo turist që hyn në Butrint ka një kamera në celularin e tij apo një kamera private dhe me këtë logjikë, duhet t'i dërgojnë të gjithë sms Kumbaros që të lejohen të hyjnë në Butrint. Deputetët e Komisionit të Medias, të kenë kujdes që të evitohen përsëritjen e këtij neni që keqpërdoret nga ministrja për të shkelur të drejtën e informimit, në momentin që do të silllet për diskutim projektligji i ri i Trashëgimisë.

### IRIS ELEZI EMËROHET DREJTORE E ARKIVIT TË FILMIT

Ministria e Kulturës ka njoftuar dje se pas përfundimit të procedurave të konkurimit të hapur dhe publik për pozicionin Drejtor i Arkivit Qendror Shtetëror i Filmit, institucion në varësi të Ministrisë së Kulturës, referuar procedurave të ndjekura nga komisioni i ngritur për vlerësimin e dosjeve konkurrese, Iris Elezi përbush kërkesat në përputhje me kriteret e vendosura. Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 4,

të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 07.03.2003 "Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose Ministrit", si dhe të nenit 14 të Statutit të AQSHF-së.

Iris Elezi emërohet në pozicionin "Drejtor, në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit".

### VIRGINIE CAQUOT, NË VENDIN E SHQIPONJAVE

Galeria Kombëtare e Arteve hap në një nga sallat e saj ekspozuese me datë 13 tetor, ekspozitën "Në Vendin e Shqiponjave, 2015 - 2017", të fotografes franceze Virginie Caquot. Ekspozita e Virginie Caquot organizohet nga Galeria Kombëtare e Arteve në bashkëpunim me Rezart Jasa, koordinator i marrëveshjes "Les temps forts entre l'Albanie et la France" në kuadër të shkëmbimeve kulturore Francë-Shqipëri. Projekti, i konceptuar dhe realizuar nga vetë autorja, paraqet përmes 30 fotografive bardhë e zi të një formati

të mesëm, një udhëtim pamor të artistes gjithkund nëpër Shqipëri gjatë periudhës shtator 2015 dhe korrik 2017. Ato kapin momente të jetës së përditshme të njerëzve, atmosferave dhe ngjarjeve. Artistja shprehet se "Fotografia ime është kryesisht intuitive, e udhëhequr nga situatat e zakonshme të përditshme të hasura gjatë udhëtimit. Gjithashtu, përpigë që ajo të jetë estetike, poetike apo e çuditshme, sepse është gjuha e shprehjes time, reflektimi i emocioneve të mia dhe pres që ajo të shprehë më shumë sesa unë mund të them me fjalë. Ajo është një dialog vizual midis meje dhe spekta-

torit. Është në dorën e tij të zbuloj këto momente nëpërmjet këndvështrimit tim. Në këtë ekspozitë unë i jap spektatorit vizionin tim për Shqipërinë sot". Virginie Caquot është një fotografë e pavarur franceze nga qyteti i Lilës. Ajo ka mbaruar studimet për Histori-Gjeografi dhe Zhvillim Social në Universitetin e Lilës, dhe fillimisht ka punuar si mësuese. Nga 2012-ën, Virginie Caquot iu kushtua krejtësisht fotografisë me të cilën është marrë prej 20 vjetësh. Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më 23 tetor 2017.



PREMIERA

Fatmira Nikolli

Misto vjen, po aq sa vinte Godoja. Ata nuk e presin Miston. Duan të ikin prej tij. Është përhapur një thashetheme se Misto ka vdekur. E besojnë se duan ta besojnë, por kur pyeten, e mohojnë, pasi pohimi do të ishte tragjedi e madhe. Misto duket se personifikon Enver Hoxhën. E përkthyer ndryshe, të njëjtat gjëra si në "Miston" e Naun Shundit, shkruar për komunizmin, ndodhin edhe sot në demokraci. Në konferencë para gazetarëve nga skena e Teatrit Kombëtar, aktorët u kujdesën të vënë në dukje se personazhi i femrës së abuzuar psikologjikisht, seksualisht dhe fizikisht si në dramë si në të përditshmen tonë, nuk mungon. "Ai Misto nuk ka ikur, nuk ka vdekur, është prapë këtu", tha Adelina Muçaj para mediave.

Drama e shkruar nga Naun Shundi vite më parë, duket se hap dyert e teatrit për dramën shqipe. Vetë autori dhe regjisori i pjesës, thotë se drama shqipe nuk mungon po nuk ka aq sa duhet. Duke sjellë l mesazhin universal të domosdoshmërisë për liri, si në sistemet diktatoriale, ashtu edhe ato demokratike, premiera e "Mistos", me autor dhe regjisor Naun Shundin vjen në datat 13, 14 dhe 15 tetor, ora 19:00, me interpretimin e aktorëve Bujar Asqeriu, Helidon Fino, Adelina Muça, Erion Kame, Niada Saliasi dhe Genti Deçka. Skenografe dhe kostumografe është Laedia Hajdari, as/regjisori Pellumb Derishi, koreograf Artan F. Ibershimi dhe kompozitor Kelmend Marku

**DRAMA**  
"Një artist duhet të jetë një person që i vë vetes qëllim të përcjellë një mesazh, të përcjellë çka brenda vetes. Ai ulet dhe shkruan atë që do të thotë, që do të komuni-



Skenë nga shfaqja

# Misto nuk ka ikur, as nuk ka vdekur

Premiera e dramës shqipe në Teatrin Kombëtar, Shundi: Mesazhi është liria



kojë. Nuk ka fat më të madh se sa këto që ke shkruar, t'ua komunikosh 500 njerëzve. Edhe në rastin më të keq, kur nuk arrin të komunikosh, mëson nga dështimi. Vepra ime nuk është shkruar në mënyrë tradicionale, ndaj e ka risikun brenda", tha Shundi para mediave. Shtoi se është shkruar ndryshe, se është veprë tipike e teatrit absurd. "Ka plot vepra që kemi parë në skenë, a në filma. Të tërë flasin për diktaturën. Ajo është trajtuar në mënyrë dramatike, duke ruajtur traditën e të

shkruarit klasik. Nuk e di dhe nuk e shpjegoj dot pse këtë veprë për të shkruar nuk e shkrova dot në mënyrë klasike. Është absurd i madh. Jetuam në një sistem ku mungesa e lirisë i ka gjymtuar psikologjikisht dhe i ka detyruar njerëzit të bëjnë marrëzira të mëdha. "Këtë jam munduar të sjell te "Misto",-tha autori. Autori, i pyetur nëse pjesë ka nota biografike shtoi se publiku nuk do ta gjejë veten te personazhet, por te situatat, te perceptimi e te mënyra si transme-

tohet halli i çdo personazhi. Sipas tij, muzika është vlerë e shtuar ndaj ka marrë muzikë shqiptare pasi për të nuk ka kuptim që një veprë shqiptare të ketë muzikë të huaj. "Mund të merrja muzikën e Beethovenit e askush nuk mund të më thoshte se ç'doje me të, por dua muzikë shqiptare. Një veprë shqiptare s'mund të vihet me muzikë të huaj. Është nonsens. Dua të ndjej shqiptarizmin në veprë".

Helidon Fino, duke folur për pjesën tha se personazhet përpëliten për këtë liri të të jetuarit, ndaj liria e interpretimit për aktorin është gjithmonë. "Personazhet janë të vështirë, por në strukturën e vet vepra nuk është klasike, njeriu deprimohet. Problematika të shoqërisë ka në çdo kohë, në çdo vend, në çdo sistem e çdo kombësi. Në këtë rast stili e mënyra e Naunit përmes ekstrakteve të shpeshta të përmbledhura në gjuhën e personazheve, ka bërë që gjuha e dialogu të sjellin sarkazëm të hollë e paradokse të bukura".

Edhe aktori i njohur, Bujar Asqeriu vlerësoi veprën, duke shtuar se kur ajo është lexuar para dy vitesh në Ditët e leximit të dramës shqipe, spikati mes të tjerave. "Është veprë e mençur dhe simbolike. Përmes absurdit sjell një mënyrë, një moment nga historia jonë e jo vetëm nga ajo e kaluara, por edhe e sotmja. Ka ende vende ku shkelen të drejtat e liritë e njeriut. Personazhet janë larg klasicizmit të dramaturgjisë, duken ndryshe, por kanë ekuilibër të brendshëm shumë të hollë për ta ndërtaur figuracionin me kujdes",-tha Asqeriu.

Vetë aktori u shpreh i kënaqur edhe për rolin e tij, pasi i ka dhënë mundësinë të shfaqë disa elemente që s'ka mundur t'i shfaqë më herët.

## NIS PROJEKTI I DIGJITALIZIMIT TË MUZEVEVE

Në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar u prezantua projekti pilot "Të fuqizojmë muzetë nëpërmjet teknologjisë, për një qasje më të gjerë për të gjithë" i cili konsideron digjitalizimin e koleksioneve dhe zbatimin e teknologjisë ndërvepruese në hapësirat e muzeve kombëtarë dedikuar artist mesjetar dhe ikonografisë të cilët ruajnë koleksione shumë të pasura dhe disa nga objektet unike të artit ikonografik në Shqipëri dhe rajon. Në prezantim merrnin pjesë, Ministria e Kulturës, znj. Mirela Kumbaro, Kryetari i Bordit të AADF-së Michael Granoff, përfaqësues të Muzeve Kombëtarë në Berat, Korçë dhe Tiranë, etj. Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro u shpreh se: "Nëse duam ta ruajmë,

ta vlerësojmë dhe ta trashëgojmë historinë tonë, duhet ti flasim vizitorit me gjuhën e kohës. Ky projekt tregon se jemi duke përdorur teknologjinë, si një nga mjetet më të mira për të vlerësuar historinë". Projekti ka për qëllim të ruajë dhe promovojë vlerën unike të këtyre fondeve muzeore duke bashkuar trashëgiminë kulturore dhe teknologjinë, si dy elementë premtues në shtërim të zhvillimit të qëndrueshëm të muzeve të konsideruar gurë themeli për industrinë e turizmit kulturor. Projekti është një nismë e AADF e cila ka angazhuar për fazën e parë të tij \$ 60.000, dhe ekspertizën ndërkombëtare të Cultural Héritage Imaging, organizatës amerikane që i ka dedikuar prej vitesh punën e saj zhvillimit shkencor të teknikeve të fotografitimit dhe ru-

ajtes së imazheve digjitale të pasurive kulturore në të gjithë botën. Kryetari i Bordit të AADF-së Michael Granoff u shpreh se "Ky vend është i rëndësishëm me histori. Në respekt të thesarit tuaj, ne jemi të gëzuar që mund ta mbrojmë këtë pasuri, së bashku me Ministrinë e Kulturës". Ky lloj koleksioni tashmë virtual nuk e ka të dytin të paktën për momentin as në Ballkan dhe as në Europë. "Projekti është për rivlerësim të trashëgimisë kulturore, për vizitorin e zakonshëm, për turistin e ardhshëm i cili përpara se sa të vijë do donte të kishte një pamje më të qartë, por është një teknikë fantastike e cila do t'u japë mundësinë studiuvese, historianëve, artistëve për të hyrë më në thellësi të veprës artistike të trashëguar", tha më tej në fjalën e saj, Ministria Kumbaro.

## AKTORI I NJOHUR NDRIÇIM XHEPA I SËMURË, QEVERIA JEP 50 MILIONË LEKË PËR KURIM

Aktori i njohur Ndriçim Xhepa vuan prej një kohe të gjatë nga një sëmundje. Qeveria ka miratuar në mbledhjen e kësaj të mërkure një vendim përmes të cilit i akordon një fond financiar prej 5 milionë lekësh të reja aktorit për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit në një klinikë jashtë vendit. Muaj më parë Ndriçim Xhepa pati probleme shëndetësore gjatë xhirimeve të një filmit në Permet. Diskret siç është dhe pa dëshirën të dalë në media, ai atëherë pat marrë pjekimine duhur dhe i qe rikthyer punës. Muaj më vonë duket se problemi janë rikthyer dhe këtë herë, është dashur ndihma financiare e qeverisë për të siguruar një mjekim më profesio-



al jashtë vendit.

### VENDIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, dhe në vijim të shkronjës "c", të pikës 9, të vendimit nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për

vitin 2017", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe

Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave VENDORI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Ndriçim Xhepa, në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. KRYEMINISTRI Edi Rama

Opinion i Ditës

# TVSH te biznesi i vogël, mund të sjellë rritje çmimesh

Nga Zija Lika

(vijon nga faqja 1)

... e në vazhdim në të ardhmen, sikurse është programuar dhe paralajmëruar kohët e fundit nga ana e qeverisë aktuale, me gjithë problematikat që do ta shoqërojnë në fazën fillestare të zbatimit, do të përbëjë një ndër masat më të rëndësishme pozitive drejt reformimit të thellë dhe kompleks të sistemit fiskal në RSH-së. Përvoja rreth 26-vjeçare e tranzicionit të tejzgjatur demokratik shqiptar, përveç të tjerash në fushën e ekonomisë na tregon se niveli i evazionit fiskal (shmagjies, zvogëlimit apo mospagimit të detyrimeve fiskale), megjithëse 10-vjeçar in e fundit ka ardhur gradualisht disi në rënie, përsëri mbetet shumë problematik duke u luhatur realisht në kuotën e 40%, ose e thënë ndryshe në vlerën e rreth 1.5 miliardë eurove.

Situata e deritanishme në fushën e mbledhjes dhe administrimit të tatim-taksave në përputhje me legjislacionin përkatës të vendit tonë, ka qenë dhe ende vazhdon të jetë problematike, ndërkohë që kjo gjë e bën edhe më të domosdoshëm, kontrollin e vazhdueshëm të sistemit tatimor e doganor, veçanërisht prej strukturave përkatëse të auditimit të jashtëm, ku roli më i rëndësishëm i takon Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në ndryshim nga vendet e zhvilluara ku pjesën kryesore të të ardhurave të buxhetit të shtetit e zënë taksat e drejtpërdrejta, në vendin tonë për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit të sistemit tatimor, taksat indirekte mbi konsumin apo shpenzimet (TVSH-ja, taksat doganore dhe akciza), janë pikërisht ato që dominojnë këto të ardhura. Bazuar në të dhënat përkatëse statistikore të publikuara nga Ministria e Financave rezultojnë se mbi 50% të të ardhurave vjetore të buxhetit të shtetit shqiptar, vilen nëpërmjet aplikimit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Është kjo ndër arsye kryesore që aplikimi, vjelja dhe miradministrimi korrekt i këtij tatimi të sipërpërmendur konform legjislacionit përkatës, merr një rëndësi tepër të veçantë, duke justifikuar plotësisht (megjithëse disi me vonë në kohë), projektin e qeverisë mbi përfshirjen në skemën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-së) prej datës 01.01.2018 e në vazhdim, të rreth 73 mijë subjekteve të biznesit të vogël me xhiro vjetore deri në 5 milionë lekë të reja, ndërkohë që pjesa tjetër e biznesit të vogël (aktualisht prej 17 mijë subjektësh), që e ka këtë tregues mbi 5 deri në 8 milionë lekë, është përfshirë në këtë skemë qysh prej vitit 2009.

Një historik shumë i shkurtër



mbi origjinën e tatimit mbi vlerën e shtuar dhe aplikimin e tij në vendin tonë.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar është një tatim indirekt mbi konsumin, origjina e të cilit është Franca në vitin 1954. Ai është konceptuar në mënyrë të tillë, që të rëndojë vetëm mbi konsumatorin final dhe jo mbi çdo subjekt apo firmë biznesi, si hallka ndërmjetëse të zinxhirit tregtar të prodhim/blerjeve dhe shitjeve, nëpër të cilat kalon malli apo shërbimi derisa të arrijë destinacionin përfundimtar. Ndërsa, për shtetin Tatimit mbi Vlerën e Shtuar është një ndër burimet kryesore të të ardhurave të buxhetit të përgjithshëm të tij, për subjektet apo firmat e biznesit ai nuk përbën as shpenzim dhe as të ardhura për to. Si rregull zbatohet për veprimtaritë ekonomike, që sjellin fitim dhe që ushtrohen në mënyrë të pavarur.

Në vendin tonë, ky lloj tatimi ka filluar të aplikohet qysh prej vitit 1995, menjëherë pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të ligjit 7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" të ndryshuar, i cili pushojë së vepruari me hyrjen në fuqi të ligjit 92, të vitit 2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH-së", i cili është përafëruar pjesërisht me direktivën e Parlamentit Europian dhe këshillit 2006/112/KE, datë 28.11.2006 "Mbi sistemin e përbashkët të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar". Shkalla standarde e këtij tatimi të aplikuar mbi vlerën e tatueshme (vlerën totale pa TVSH), ka qenë dhe është 20%, ndërkohë që ekzistojnë edhe dy shkallë të tjera tatimore, përkatësisht 0% në eksporte dhe 6% në sektorin e turizmit, duke filluar prej muajit qershor 2017 e në vazhdim.

Si funksionon mekanizmi i TVSH-së?

Mekanizmi i funksionimit dhe përlllogaritjeve të Tatimit mbi

Vlerën e Shtuar është i njëjtë në të gjitha vendet e botës, që e aplikojnë këtë lloj tatimi, me përjashtim të ndryshueshmërisë së shkallëve tatimore nga njëri vend në tjetrin, në varësi të politikave të ndryshme fiskale të ndjekura nga qeveritë përkatëse.

Më konkretisht, secili prej subjekteve të biznesit në rolin e hallkave ndërmjetëse të zinxhirit tregtar, që fillon me prodhuesin apo importuesin dhe përfundon me subjektin e fundit, që realizon shitjen përfundimtare të një malli/shërbimi të konsumatorit final, detyrohet ligjërisht të paguajë për llogari të buxhetit të shtetit, shumën e barabartë me 20% të diferencës midis vlerës së tatueshme (vlerës totale pa TVSH) në shitje dhe në blerje, bazuar në të dhënat përkatëse të konfirmuara në formularin e deklarimit mujor të TVSH-së, për llogari të organit tatimor.

Çdo subjekt i këtij zinxhiri, shumën e TVSH-së të llogarituar në blerje ia ka paguar më parë subjektit përkatës paraardhës, prej të cilit është furnizuar me mallra/shërbime dhe për rrjedhojë e zbrit prej shumës së TVSH-së, të llogarituar në shitje, duke përcaktuar kështu në mënyrë korrekte detyrimin ndaj buxhetit të shtetit, i cili në total duhet të arketojë prej të gjitha subjekteve të këtij zinxhiri, shumën e barabartë me 20% të vlerës së tatueshme (vlerës totale pa TVSH), të rezultuar në shitjet përfundimtare ndaj konsumatorëve finale.

Kështu për shembull, nëse subjekti i fundit i zinxhirit tregtar, i cili realizon shitjen përfundimtare të konsumatorit final, blen një njësi malli nga subjekti paraardhës me çmimin 120 lekë, ku 100 lekë është vlera e tatueshme (vlera totale pa TVSH) dhe 20 lekë TVSH-ja e llogarituar në blerje dhe nga ana tjetër e shtet atë të konsumatori fi-

nal me çmimin 150 lekë, ku 125 lekë është vlera e tatueshme (vlera totale pa TVSH) dhe 25 lekë TVSH-ja e llogarituar në shitje, atëherë ky subjekt që në rastin konkret është në rolin që do të jetë çdonjëri prej subjekteve të biznesit të vogël pas hyrjes në skemën e TVSH-së (sikurse themi më sipër), i detyrohet buxhetit të shtetit të paguajë një vlerë TVSH-je, të barabartë me 5 lekë = (25 - 20) lekë = 20% (125 - 100) lekë = 20% X 25% X 100 lekë, ku 25% është në këtë rast, norma e fitimit bruto për njësi malli = (125 - 100) : 100 = (150 - 120) : 120.

Bazuar në të dhënat e këtij shembulli, nëse krahasojmë këtë variant, ku subjekti në fjalë është përfshirë në skemën ligjore të TVSH-së dhe fitimin bruto për njësi malli e ka të barabartë me 25 lekë = (125 - 100), me variantin tjetër ekzistues të mospërfshirjes së këtij subjekti në këtë skemë (për shkak të xhiron vjetore me vlerë më të ulët se 5 milionë lekë të reja), ku fitimin bruto për njësi malli e ka të barabartë me 30 lekë = (150 - 120), rezultojnë se fitimi bruto për njësi malli në lidhje me këtë subjekt në variantin e parë zvogëlohet me 5 lekë = (25 - 30), ndërkohë që sikurse përlllogaritjet në paragrafin e mësipërm, norma e fitimit bruto për njësi malli mbetet konstante e barabartë me 25% = (125 - 100) : 100 = (150 - 120) : 120.

Lidhur me sa më sipër, natyrisht lind pyetja:

Deri sa mund ta rritë çmimin subjekti në fjalë (nëse konkurrenca në treg ia lejon një gjë të tillë), në mënyrë që ai të ruajë të njëjtin vlerë të fitimit bruto për njësi malli që ishte më parë, të barabartë me 30 lekë dhe jo 25 lekë që rezultojnë, si pasojë e përfshirës së tij në skemën ligjore të TVSH-së?

Nga përlllogaritjet ekonomiko-matematikore, rezultojnë se subjekti në fjalë me qëllim që të realizojë atë çka themi, duhet ta ndryshojë

çmimin nga 150 lekë për njësi malli që ishte më parë në 156 lekë, duke e rritur atë në madhësi absolute vetëm me 6 lekë, ose e thënë ndryshe në madhësi relative të barabartë me 4% = (6 : 150). Nga rritja prej 6 lekësh e çmimit, 5 lekë shkojnë për të rritur fitimin bruto të subjektit për njësi malli nga 25 lekë në 30 dhe 1 lekë i shtohet detyrimin që ai ka ndaj buxhetit të shtetit në lidhje me TVSH-në nga 5 lekë që ishte në 6. Mbështetur në sa më sipër, është e rëndësishme të kuptohet dhe argumentohet se: Deri ku shkon liria dhe mundësia e subjektit të biznesit, për të rritur pa asnjë lloj kufizimi çmimet në kushtet e funksionimit të një ekonomie mikse, ku vendimet merren përgjithësisht nga tregu dhe pjesërisht nga qeveria.

Në lidhje me këtë, modeli i strukturës së tregut (konkurrencë e plotë, apo monopolistike, oligopol, oligopson, monopol, monopson e të tjera), natyra e mallrave dhe shërbimeve, si dhe elasticiteti i kërkesës në lidhje me çmimin që karakterizon ato, janë ndër faktorët kryesorë që përcaktojnë mundësinë e subjekteve të biznesit për të ndryshuar çmimet, në funksion të maksimizimit të përfitimit ekonomik.

Së pari, për një numër shumë të kufizuar mallrash dhe shërbimesh publike, si furnizimi me energji elektrike, ujë të pijshëm, tarifata e qirave të strehimit në konvikte të nxënësve dhe studentëve me vendbanim të largët e të tjera, të cilat kanë një rëndësi shumë të madhe për sigurimin e kushteve normale të jetesës për mbarë banorët e një vendi, funksionon mekanizmi rregullator i çmimeve tavan, të cilat vendosen nga entet përkatëse rregullatore, apo qeveria në mbrojtje të interesit të konsumatorëve, duke i detyruar të gjitha subjektet e biznesit që tregtojnë ato, të vendosin dhe aplikojnë çmime në vlera jo më të larta se ato tavan respektive. Kjo ndërhyrje e qeverisë është plotësisht e justifikuar, pasi kostot e ndërhyrjes janë shumë më të vogla se ato të ndërhyrjes, aq më tepër që këto mallra e shërbime publike tepër jetike, ofrohen përgjithësisht nga një firmë e vetme në një treg tipik monopolist, të cilin qeveria përmes agjencive rregulluese shtetërore duhet ta kontrollojë përsa i takon nivelin të çmimeve, cilësisë së shërbimeve e të tjera, apo të kalojë në pronësi shtetërore këtë firmë monopoliste.

Së dyti, për të gjitha mallrat dhe shërbimet e tjera, veçanërisht në kushtet e konkurrencës, çmimet vendosen në treg si rezultat i bashkëveprimit të kërkesë-ofertës për to, ndërkohë duhet theksuar se sa më shumë struktura e tregut i përafrohet modelit përkatës në konkurrencë të plotë, aq më shumë zvogëlohet dhe tenton drejt eliminimit të →





Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

# ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

## Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikën e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së njëmbëdhjetë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikën që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Tra-

jtitimit të Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkuar, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjister janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe pro-

blematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodër, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfutojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të trullit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

### LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E NJËMBËDHJETË)


(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohur e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika	Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohur e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Simon	Gilaj	Ndue	Gilaj		Zagore / 3870	33	14807	4577	Vendimi nuk u ankimua. Nga sip. Totale e njohur është zbritur sip. 5000 m <sup>2</sup> e kthyer me ligjin 7698 dhe sip. E perfituara nga ligji 7501	Dan	Bala	Adem	bala	36000 TB	Gruemire / 1871	27	36000	36000	Ka vert.pronësie Nuk ka Harte. Vendimi nuk u ankimua
										Dede	Gjoni	Dede	Gjoni			25			Vendim negativ per mungese dokumentacioni. Ka vert.pronësie Nuk ka Harte. Vendimi nuk u ankimua
										Teufik ; Shefik ; Gani	Bekteshi	Mehmet	Bekteshi	63000	Grile / 1864	26	63000	63000	Ka vert.pronësie Nuk ka Harte. Vendimi nuk u ankimua
										Mark	Nika	Mark	Nika			24			Vendim negativ per mungese dokumentacioni. Ka dokum.ar kivor Nuk ka Harte. Vendimi nuk u ankimua
										Martin	Kalaj	Martin	Kalaj			23			Vendim negativ per mungese dokumentacioni. Ka vert.pronësie Nuk ka Harte. Vendimi nuk u ankimua
										Sadik	Dilaveri	Sadik	Dilaveri			22			Vendim negativ per mungese dokumentacioni. Ka vert.pronësie Nuk ka Harte. Vendimi nuk u ankimua
										Smajle	Veli	Bardhyl	Brahimi		Grile / 1864	28	5000	5000	Ka vert.pronësie Nuk ka Harte. Vendimi nuk u ankimua

Mark	Selca	Mark	Selca			16	Vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Gezim	Tahiri	Gezim	Tahiri			17	Vendim negativ per mungese dokumentacioni		Nuk ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Gjergj	Duka	Gjergj	Duka			18	Vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Cezar	Bekteshi	Cezar	Bekteshi			19	Vendim negativ per mungese dokumentacioni		Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Mati	Guli	Trashigim taret		47 000	Vrake / Grude/	20	47000	47000	Ka vert.pron esie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua Sipas disozitivite vendimit nga sip. Totale e njohur per kompensim sip. 27.5 dy ndodhet ne Vrake dhe 19.54 dy ne Grude				
Ymer	Kraja	Arshi	Kraja	1180	8594	26	3180	1180	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Musa	Causholli	Trashigim taret Causholli		247	8591	27	247	127	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Xhemal	Duli	Trashigim taret	Duli	1100	8591	28	1100	350	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Tahir	Tevija	Shyqyri	Tevija	7 dy truall		29	7000		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Luigj	Marku	Luigj	Marku	10 dy		16	3260	3540	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Jonuz	Malevija	Jonuz	Malevija	14 dy	Berdice / 1157	17	7000	3000	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Qazim	Malevija	Trashigim taret	Malevija	14 dy	Berdice / 1157	18	7000	3000	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua				
Nazmi	Bekteshi	Arjana	Bekteshi				820 m2 , 260 m2 pemishte		19	830	155	Ka Verte.pronsie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Shaban ; Ragip ; Jonuz	Kadia	Ismail	Kadia				13720 m2		20			vendim negativ Kjo sip. Eshte trajtuar nga komisioni KKP te Bashkise me V.868 dt 17.10.96	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Qazim	Ramadani	Sokol	Ramadani				6 dy truall	Golem / 1790	21	6000	1920	Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Faik	Kadia	Mustaf	Kadija				12 dy		22	5100		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Eljaz	Burani	Eljaz	Burani				326 m2 truall	Lagj Kiras Shkoder /	23	326	326	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Mehmet	Mema	Selim	Mema				1500 m2 truall	Lagj Tophane Shkoder /	24	1500	300	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Hamid	Kraja	Muhamet	Kraja				1400 m2 truall	Lagj Dudas Shkoder /	25	1400		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Rasim	Sokoli	Rasim	Sokoli				Sip. E papercaktuar		1			Vendosi mosmarrjen ne shqyrtim te dosjes	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Cen	Lika	Abdulla	Lika				1380m2 truall + shtepi me oborr	Shkoder	2	385.7	72.5	Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Riza	Nehani	Hashim	Nehani				100m2 truall+nje kulle	Lagj Dergut Shkoder /	3	370	270	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Ragip, Emin	Xhabija	Smajl	Xhabija				3300m2 truall	Lagj Manush Alimani Shkoder /	4	3315	415	Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Sokol	Kosova	Sokol	Kosova					Lagj Skenderbeg Shkoder	5	1250		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Nafize	Hoxha	Agim	Hoxha				1580 m2 dhe 2060 m2 truall	Lagj Rus Shkoder /	6	3640		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Ethem ; Selim	Zaganjori	Taip	Ndruka				6 dy kullote 3 dy truall	Bahcallek Shkoder	8	3000		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	
Kisha Provincane Shqiptare	Franceska	Kisha Provincane Shqiptare	Franceska						9	8656	1024	Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	

(Vijon nesër)

### Fjalëkryqi (1)



**HORIZONTAL**

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashtë.
- Është Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhën për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotualet.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë.
- Preka komik shkodran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë
- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.

**VERTIKAL**

- Si i përshatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Është metri i rrobaqepësist.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë.
- Ishin monedhe te Tobias.
- Është bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Është marrëveshje me nota.
- Ishite babai i Akilit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Është faqe muri.
- Një apendisit i menjëherëshëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Vriten nga espada.
- Është shtet aziatik.
- Edouard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Uni i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samurai.


### Fjalëkryqi (2)

**HORIZONTAL**


- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Është ngingjia.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sette.
- Ente Ekonomike Sarandë.

**VERTIKAL**


- Mbyllin një ditar.
- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Është kolana në filma
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Është tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.
- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Është edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castellitto aktor.
- Inciliat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Është trysni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktor.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.



### Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

NENTOKA ASC E  
TRUP TALENTE S  
ORER PANTERAT  
KEL KANDILET  
BAKUNIN ADAM  
TAMARO CO OAK  
ME TONI AT NDU  
AT TONIK PTER  
RIT LLI ZE OTTO  
KEVA DETI EIR  
ELSA PAL NO  
TAT PIRATERIA

**FJALËKRYQI (2)**

TIRANA H RP  
ORARI B TEATER  
ROMA KABIRBEDI  
TNA BARITONI L  
UI RAMBO I  
RADI PAGANIZMI  
T PARTIAK INAT  
LALA FEMRA H  
PELIKANTI THY  
M I JASONTI E  
APARATE PA

### SUDOK

	9		8			5		
3			5	1	9			6
6	2		4				8	9
			1			8		9
7	4						3	1
	5		3			2		
5	6				2		7	4
4			9	7	3			8
			3		4			1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	2	5	7	4	8	1	3	6
8	3	4	1	6	2	5	9	7
1	6	7	5	9	3	4	8	2
6	5	9	2	8	7	3	4	1
3	8	2	4	1	5	6	7	9
7	4	1	9	3	6	8	2	5
2	7	8	6	5	4	9	1	3
4	9	6	3	2	1	7	5	8
5	1	3	8	7	9	2	6	4

### Argëtim filozofik

- Udhëtari, nëse nuk takon një shoqëruar më të mirë ose të ngjashëm me veten, vazhdon i bindur vetëm: nuk bëhet shoqëri me budallain.
- Ashtu si një shkëmb masiv nuk tundet nga era, ashtu edhe të mënçurit nuk lëkunden mes fajësimeve dhe lavdërimeve.
- Uji kanalizon burimet, harkëtarët lakojnë shijetat, marangozët përkulën drurin, të mënçurit vetëbinden.

### KRIPTOSKEME

### KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2		7	3		13		2		
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6	
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6	
	3	5	8	2	3	5	6	1	7	5		
12	5	13	5	10	1	7		6		13		
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6	
8	2	6	2		2	1	8	5	11	1		
1	6	8		17	9	5	7	2		9		
3	1	5		8	2	16			2	7	1	
2				3	2	6	5	9	2		13	
6	2	7	2			3		7	18	3	6	T
	3	4	8	5	19	1	5		3	5	2	

R	A	S	T	E	T	P	A	P		
U	R	A	T	U	R	H	P	A		
S	A	M	M	M	A	R	A	I	S	
I	A	M	E	R	I	K	A	N	E	
P	R	O	T	E	S	T	A	N	T	E
G	J	I	G	A	N	T	I	R	U	
B	E	T	O	N	E	K	B	O	R	
S	A	L	I	R	A	M	A			
T	O	N	T	I	T	U	L	L	I	
A	R	E	S	A	O	E	R			
P	J	A	R	Z	O	T	I	M	I	
A	A	M	E	R	E	N	G	U	E	S

### Thënie të mënçura

- Për të patur sukses, dëshira jote për sukses duhet të jetë më e madhe se frika nga dështimi.
- Dhimbja e nxit njeriun të mendojë. Mendimi e bën njeriun të mënçur. Mënçuria e bën jetën të lehtë.
- Njerëzit mërziën nga fëmijëria, nxitojnë të rriten, më pas shpresojnë të kthehen në vegjël (fëmijë) përsëri.
- I thashë Zotit, "Më ruaj nga armiqët" dhe fillova të humbas miqtë...

Bill Cosby

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

www.gsh.al

## GAZETA SHQIPTARE



## Tashmë edhe lundroni!

